

VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.8(445)


GUSHT 2025

ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI ; website: www.VETERANIOBVL.ORG

REFLEKSIONE

USHTRIA SHQIPTARE ISHTE PARAROJA E UÇK-SË



Nga Bashkim HISARI

FAQE 8

CEREMONIA

NDERIMI PËR HEROIN INDRIT CARA NË PËRVJETORIN E LINDJES SË TIJ



Luftoi dhe dha jetën për Kosovën, heroi kombëtar nderohet në 54-vjetorin e lindjes me një ceremoni

FAQE 9

LIBRI

FLAMUR MICKO DHE LIBRI I TIJ PËR AVIATORËT SHQIPTARË



Nga Sakip Cami

FAQE 6 - 7

OBVLP U KRIJUA NGA 64 PERSONALITETE, ISH-DREJTUES TË LANÇ, TË USHTRISË SHQIPTARE E STRUKTURAVE TJERA QEVERITARE

31 VJET OBVLP, MBROJTËSE E VLERAVE TË LIRISË

HISTORI SUKSESI

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës (OBVLP) në 31 vjet veprimtari ka përmbushur misionin e saj historik, të ruajtjes, mbrojtjes e zhvillimit të vlerave të Luftës, nga më të lavdishmet për liri e pavarësi të shqiptarëve në trojet e tyre etnike në Ballkan, të luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare kundër pushtuesve fashistë italianë e nazistëve gjermanë.

OBVLP, veteranët dhe pasardhësit e tyre, anëtarë të kësaj organizate ndjehen më krenarë se kurrë me historinë e saj të suksesshme 31 vjeçare dhe angazhohen për të ecur në shembullin e themeluesve, që organizata jonë të vazhdojë të funksionojë si mbrojtëse e flaktë e vlerave të lirisë.....

FAQE 3



TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU - Kryetare e OBVLP:

- Na takon ne pasardhësve të veteranëve që vunë rininë e tyre në shërbim të lirisë dhe dhanë jetën në luftë me okupatorin nazifashist, të përçojmë te brezat e rinj patriotizmin dhe atdhedashurinë. Ne mbetemi të angazhuar totalisht për arritjen e bashkimit dhe pajtimit kombëtar sipas idealeve dhe mesazheve të Konferencës së Pezes që janë aktuale edhe në ditët e sotme.
- Ne veteranët dhe pasardhësit, të bashkuar me frymën e mirëkuptimit dhe tolerancës do të promovojmë më mirë vlerat patriotike dhe traditat luftarake të LANÇ-it duke u transmetuar brezave mesazhin se interesat e atdheut qëndrojnë mbi interesat e Partive, ato janë të shenjta dhe mbrohen më mirë kur jemi të bashkuar....

FAQE 2

DOSSIER

HISTORIA E LAVDISHME E BRIGADAVE TË 16-të, 17-të, 18 -të DHE 19-të SULMUSE PARTIZANE

FAQE 4 - 5

HISTORI

HITO KONGOCI-FUSHËBARDHA TOPÇIU I PARË SHQIPTAR LUFTËTAR I SHEKUJVE

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI FAQE 12

OPINION

BAZAT E LANÇ-FORTESA QËNDRESE DHE FRYMËZIM PËR BREZAT

MEVLUD BUCI

FAQE 13

ESSE

KULLA QË MBAN VULËN E LUFTËS

Nga Nexhbedin Basha

FAQE 11

SUPLEMENTI LETRAT

TË VËRTETAT E HIDHURA NË TREGIMIN E KADRI TARELLIT

SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 15

REPORTAZH

Stublla - Fshati i historisë, arsimit dhe shpirtit të mërguar

Nga Rajmonda Maleçka

FAQE 10

PROMOVIMI

Dhjetëra personalitete akademike dhe të letrave në promovimin e librit tim të: 29-të



Halil RAMA - Mjeshtër i Madh

Mehdi Luca, embleme e qytetarisë dibrane

FAQE 15

SPECIALE

OBVLP U KRIJUA NGA 64 PERSONALITETE, ISH-DREJTUES TË LANÇ, TË USHTRISË SHQIPTARE E STRUKTURAVE TJERA QEVERITARE

31 VJET OBVLP, MBROJTËSE E VLERAVE TË LIRISË

Nga Halil RAMA –
Mjeshtër i Madh*

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar dhe pasardhësve (OBVLP), më 18 korrik 2024 mbushi 31 vjet nga krijimi i saj.

Në më shumë se tri dekada aktivitet intensiv, OBVLP u dëshmuua para shqiptarëve si Organizata që vlerëson lart kontributin e shquar të popullit shqiptar në Luftën e Dytë Botërore, që dënon krimet e komunizmit, që mbështeti fort Luftën e drejtë të UÇK dhe në tërësi çështjen mbarëkombëtare shqiptare.

Që nga krijimi, mbi 15 mijë veteranë e pasardhës të tyre, milituan deri në vdekje dhe militojnë edhe aktualisht në këtë organizatë, në të mirë të demokracisë shqiptare dhe të së ardhmes së brezave, duke mbrojtur dhe promovuar vlerat e LANÇ të popullit shqiptar që e renditi Shqipërinë në krahun e fitimtarëve të Luftës së II-të Botërore.

PROMOTORE E MBROJTJES SË VLERAVE TONA KOMBËTARE

Rënia e Murit të Berlinit në nëntor 1989 dhe ndryshimet demokratike në Evropën Lindore u reflektuan edhe në Shqipëri me përmbyshjen e diktaturës komuniste, duke sjellë ndryshimin e sistemit shoqëror dhe kalimin në demokracinë e bazuar në pluralizmin partiak dhe sigurimin e lirisë së njeriut. Por, drejtuesit e shtetit të ri mbetën politikanët me prejardhje nga diktatura komuniste, më e egra në Evropën Lindore dhe rrjedhimisht qeverisja e re nuk mund të ishte plotësisht demokratike. Në këto kushte veteranët e luftës që nuk kishin marrë pjesë në krimet e PPSH dhe Enver Hoxhës, u mblodhën para 31 viteve (korrik 1994) dhe krijuan Organizatën e Bashkuar të Veteranëve të Luftës (OBVLP), që kishte për qëllim të mbështeste proceset demokratike dhe shtetin ligjor dhe t'i bashkonte veteranët e Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare të popullit shqiptar në një organizatë të vetme, për të ruajtur më mirë traditat e luftës dhe të drejtat e tyre.

Kësisoj, e krijuar para 31 vitesh me nismën e një grupi prej 64 personalitetesh, gjeneralësh dhe luftëtarësh, figura politike të respektuara, por fatkeqësisht të dënuar nga regjimi komunist, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar (OBVLP) do të bëhej promotore e mbrojtjes së vlerave tona kombëtare. Në këtë grup bënë pjesë figura politike të respektuara që kishin qenë drejtues të reparteve partizane, mnistra e zv/ministra, siç ishin: Dr. Ymer Dishnica, gjeneral Rahman Parllaku, gjeneral Nexhip Vinçani; Sadik Bektashi (gjen-

TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU – Kryetare e OBVLP:

- *Na takon ne pasardhësve të veteranëve që vunë rininë e tyre në shërbim të lirisë dhe dhanë jetën në luftë me okupatorin nazifashist, të perçojmë te brezat e rinj patriotizmin dhe atdhedashurinë. Ne mbetemi të angazhuar totalisht për arritjen e bashkimit dhe pajtimit kombëtar sipas idealeve dhe mesazheve të Konferencës së Pezes që janë aktuale edhe në ditët e sotme.*
- *Ne veteranët dhe pasardhësit, të bashkuar me frymën e mirëkuptimit dhe tolerancës do të promovojmë më mirë vlerat patriotike dhe traditat luftarake të LANÇ-it duke u transmetuar brezave mesazhin se interesat e atdheut qëndrojnë mbi interesat e Partive, ato janë të shenjta dhe mbrohen më mirë kur jemi të bashkuar*



eral lejtant - Hero i Popullit), gjeneral Muhamet Prodani, Skënder Malindi, Edip Ohri, Kiço Ngjela, Manol Konomi, Fadil Paçrami, Maqo Çomo, dhe Ernest Jakova; luftëtarët e shquara, drejtues në luftë e aktiviste të OBVLPP: Selfixhe Broja(Ciu), Zenepe Golemi (Ashiku), Liri Belishova, Vera Ngjela (Pojan) e disa të tjera, por fatkeqësisht të dënuara nga regjimi diktatorial i Enver Hoxhës.

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar (OBVLPP) është një organizatë shoqërore atdhetare. Ajo u formua që të vlerësojë realisht historinë e luftës së lavdishme Nacional Çlirimtare, që të shmangë shtrembërimet e periudhës së regjimit totalitar, mohimet dhe politizimet e bëra si rezultat i regjimit diktatorial të E.Hoxhës, por edhe me qëllim të caktuar nga individë që kërkonin lavdi dhe pushtet të pamerituar. Në kurthin e tyre ranë me dëshirë dhe me servilizëm historianë të ndryshëm që e shtrembëruan historinë e LANÇ.Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ u shtri rrufeshëm në gjithë Shqipërinë. U krijuan dhe u konsoliduan degët tona në rrethet si vijon: Në Tiranë me kryetar z.Muhamar Spahiu, Korçë, me kryetar Z.Haxhi Runi, Elbasan me kryetar z.Sami Vinçani, Durrës, me kryetar z.Idriz

Hoxha, Shkodër me kryetar z.Muharem Bushati, Lushnjë me kryetar.z.Illiaz Ahmeti, Krujë me kryetar z.Fadil Veseli; Lezhë me kryetar z.Loro Gjeçi, Tropojë me kryetar z.Hamit Neziri; Fier me kryetar z.Nazif Ago, Mat me kryetar z.Ismail Muharremi, si dhe në të gjitha rrethet e vendit. Vlen të përmendet kontributi i veteranëve Fluturak Vinçani (Korçë), Genc Ballanca (Durrës), Osman Xhindoli (Shijak), Jorgji Terca (Tiranë), Xhemal Meçi (Pukë), Agim Dylgjeri(Elbasan), Ali Demushi(Shkodër) etj. Tre vitet e fundit OBVLP ka riorganizuar degët e saj në qarqet kryesore, si Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër e Dibër, në drejtimin e të cilave janë zgjedhur personalitete të njohura publike, si ish – ushtaraku Mazllum Parllaku (Tiranë); publicist dhe shkrimtari i mirënjohur Shpendi Topollaj (Durrës), studjuesi Ali Demushi me karrierë të gjatë si officer shembullor (Shkodër) mësuesi veteran, shkrimtari dhe publicist Mevlud Buci (Dibër) etj.

KATËR PERSONALITETE TË OBVLP-SË “NDERI I KOMBIT”- TRI RRUGË NË TIRANË ME EMRAT E GJENERAL PARLLAKUT, LIRI BELISHOVËS DHE EDIP OHRIT

Pikërisht për rolin që ka luajtur, si



mbrojtëse dhe promovuese e vlerave më të mira kombëtare shqiptare, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftërave për Liri e Pavarësi të Popullit Shqiptar (OBVLP) është ndër organizatat më të vlerësuara nga institucionet shtetërore, me katër personalitete “Nderi i Kombit”.

Me këtë titull të lartë të akorduar nga ish-presidentët Nishani e Meta janë vlerësuar dy kryetarët e parë të OBVLP: Dr. Ymer Dishnica e gjeneral Rahman Parllaku, si dhe gjeneralët Nexhip Vinçani e Veli Dedi.

Ndërkohë, me “Dekoratën e Artë të Shqiponjës” janë dekoruar ish-themeluesit dhe drejtuesit ndër vite të kësaj organizate: Ish-nënkryetari dhe kryetari i saj, kolonel Myfit Guxholli, ish-sekretari i Përgjithshëm Edip Ohri dhe anëtarët e kryesisë: Liri Belishova e Hamit Keçi. Po ashtu, me propozimin e OBVLP ju është akorduar “Dekorata e Artë e Shqiponjës” komandantit të Çetës së parë Partizane të Gollobordës, patriotit të madh me rrezatim mbarëkombëtar Ahmet Cami, si dhe ish-kuadrit të Brigadës së 18, Ismail Bara.

vijon në faqen 3

SPECIALE

OBVLP U KRIJUA NGA 64 PERSONALITETE, ISH-DREJTUES TË LANÇ, TË USHTRISË SHQIPTARE E STRUKTURAVE TJERA QEVERITARE

31 VJET OBVLP, MBROJTËSE E VLERAVE TË LIRISË

vijon nga faqja 2

Në 10 vitet e fundit janë dekoruar me titullin "Mjeshtër i Madh" drejtuesit aktualë të OBVLP: Sekretari i Përgjithshëm, akademik Halil Rama, nënkryetari Muharrem Gjoka dhe kryetari i Degës së OBVLP Pukë, studiuesi dhe shkrimtari i mirënjohur Xhemal Meçi. Ndërkohë Këshilli i bashkisë Tiranë, me propozimin e Kryesisë së OBVLP ka vendosur që gjerdanit të artë të vlerësimeve për personalitetet e OBVLP-së t'i shtohet edhe emërtimi i tri rrugëve kryesore të Tiranës me emrat e gjeneral Rrahman Parllakut, Liri Belishovës dhe Edip Ohrit.

ANËTARE E FEDERATAVE EUROPIANE DHE BOTËRORE TË VETERANËVE

Me një aktivitet intensiv në mbrojtjen dhe promovimin e këtyre vlerave, dr. Dishnica dhe gjeneral Parllaku arritën ta bëjnë OBVLP-në anëtare të Federatave Evropiane dhe Botërore të Veteranëve. Me pjesëmarrjen në aktivitetet e këtyre Federatave, jo vetëm në Evropë, por edhe në Malajzi, në Johaneshburg, Marok etj, OBVLP-ja ka bërë të njohur kontributin e popullit shqiptar në Luftën e II-të Botërore dhe në luftërat për liri të popullit tonë në Kosovë, Maqedoni e deri dhe kontributin që jep sot në mbrojtje të paqes në kuadrin e NATO-s. Nisur nga ky aktivitet intensive dhe vlerat që mbron e promovon, OBVLP vlerësohet për orientim e drejtë, për veprimtarinë e gjallë të saj, për vetëdijen dhe besimin e veteranëve dhe pasardhësve, anëtarë të organizatës, jo vetëm në luftë, por edhe në demokraci.

OBVLP DHE ORGANIZATA E VETERANËVE TË LANÇ TË KOSOVËS NË NJË FEDERATË TË PËRBASHKËT

Në një aktivitet të rëndësishëm në kuadrin e 14-vjetorit të pavarësisë së Kosovës (14 shkurt 2022) u finalizua krijimi i Federatës Shqiptare të Veteranëve të Luftërave për liri e pavarësi të popullit shqiptar. Kështu, pas një pune intensive gati trevjeçare, OBVLP e Shqipërisë, trashëguese e denjë e themeluesve dhe drejtuesve të saj: Dr.Ymer Dishnica – "Nderi i Kombit" e gjeneral Parllaku- "Hero i Popullit" e "Nderi i Kombit" dhe Organizata e Veteranëve të LANÇ të Kosovës, e themeluar dhe drejtuar nga Heroi i Popullit FADIL HOXHA-ARKITEKT I KOSOVËS SË LIRË, finalizuan krijimin e kësaj federate.

Fokusi i saj, në përbërje të të cilës janë Organizata e Veteranëve të LANÇ të Kosovës dhe OBVLP të Shqipërisë, do të jetë edukimi atdhetar i rinisë, nisur nga tradita shekullore e popullit shqiptar, nga përvoja dhe programet

e Federatave Botërore e Europiane të Veteranëve, si dhe në pikëpamjet e përbashkëta programore, të fokusuara në organizimin e veprimtarive të përbashkëta për: mbrojtjen e vlerave historike të popullit tonë nëpër shekuj; evidencimin dhe promovimin e ngjarjeve dhe datave historike; përkujtimin e datave të kuvendeve historike shqiptare, si Kuvendi i Lezhës, Lidhja e Prizrenit, Pavarësia e Shqipërisë, Konferenca e Pezës, Konferenca e Bujanit, Pavarësia e Kosovës etj.

Në Akademinë Jubilarë që Federata organizoi në Gjakovë me rastin e 80-vjetorit të Fitores ndaj fashizmit (9 Maj 2025), kryetarja e OBVLP Tatjana Parllaku Çarkaxhiu, ndër të tjera tha se: "Na takon ne pasardhësve të veteranëve që vunë rininë e tyre në shërbim të lirisë dhe dhanë jetën në luftë me okupatorin nazifashist, të perçojmë te brezat e rinj patriotizmin dhe atdashedurinë. Ne mbetemi të angazhuar totalisht për arritjen e bashkimit dhe pajtimin kombëtar sipas idealeve dhe mesazheve të Konferencës së Pezës që janë aktuale edhe në ditët e sotme.... Ne veteranët dhe pasardhësit, të bashkuar me frymën e mirëkuptimit dhe tolerancës do të promovojmë më mirë vlerat patriotike dhe traditat luftarake të LANÇ-it duke u transmetuar brezave mesazhin se interesat e atdheut qëndrojnë mbi interesat e Partive, ato janë të shenjta dhe mbrohen më mirë kur jemi të bashkuar...."

MBROJTËSE E FLAKTË E VLERAVE TË LIRISË

OBVLP, veteranët dhe pasardhësit e tyre, anëtarë të kësaj organizate ndjehen më krenarë se kurrë me historinë e saj të suksesshme 31 vjeçare dhe angazhohen për të ecur në shembullin e themeluesve, që organizata jonë të vazhdojë të funksionojë si mbrojtëse e flaktë e vlerave të lirisë. Mbrojtja, propagandimi, ruajtja, mbajtja gjallë e vlerave të historisë sonë kombëtare, e veçanërisht atyre të LANÇ-it, dhe transmetimi i tyre te brezat pasardhës është dhe mbetet qëllimi themelor i OBVLPsë.

Ne ndjehemi më krenarë se kurrë për faktin që Shqipëria gjatë Luftës së Dytë Botërore u vendos në anën e antifashistëve, fitimtarëve, dhe frontit të madh të lirisë, meritë kjo e partizanëve shqiptarë, këtyre kalorësve të çlirimit dhe të lirisë.

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës (OBVLP) në 31 vjet veprimtari ka përmbushur misionin e saj historik, të ruajtjes, mbrojtjes e zhvillimit të vlerave të Luftës, nga më të lavdishmet për liri e pavarësi të shqiptarëve në trojet e tyre etnike në Ballkan, të luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare kundër pushtuesve fashistë italianë e nazistëve gjermanë.



OBVLP u themelua me përmbysjen e sistemit diktatorial enverian në përputhje me frymën e përpjekjeve për bashkim të shqiptarëve, shprehur në Konferencën e Pezës dhe Marrëveshjen e Mukjes, me program e statut gjithëpërfshirës. Ajo dha një kontribut të çmuar gjatë këtyre tri dekadave të periudhës së tranzicionit të brishtë, ende të papërfunduar në RSH.

OBVLP përfshiu në radhët e saj ushtarakë e veteranë të OUPLSH, të organizatave demokratike të veteranëve, shtesa veteranësh jashtë tyre dhe kreu veprimtari në lëvizimin e vlerave, të traditës e të legjislacionit, në dobi

të veteranëve, të invalidëve e familjeve të dëshmorëve si dhe në hartimin e legjislacionit për këto shtresa. OBVLP, në veprimtarinë e saj u distancua nga sistemi totalitar i partisë-shtet. Ajo shtriu bashkëpunimin e saj me të gjitha shtresat, pa paragjykuar bindjet e tyre; me ata që përkrahën luftën, e mbështetën atë dhe e ndihmuan, e që sot ende nuk përfaqësohen me organizata të veçanta. OBVLP ka njohur shtetin ligjor; ka bashkëpunuar me institucionet e pavarura të tij dhe ka ndërmarrë nisma në dobi të veteranëve, invalidëve e familjeve të dësh-

Vijon në faqen 16

DOSSIER

HISTORIA E LAVDISHME E BRIGADAVE TË 16-të, 17-të, 18-të dhe 19-të S PARTIZANE

81 vjet nga formimi i Brigadës së 16-të Sulmuese

Më 20 gusht 2024 mbushen plot 81 vjet nga formimi i Brigadës së 16-të Sulmuese, e cila u krijua më 20 gusht 1944 me luftëtarët e një batalioni të Beratit, dy batalione të Mallakastrës dhe me një çetë vullnetare të Lushnjes me rreth 465 luftëtarë të organizuar në tre batalione. Për një kohë fare të shkurtër numri i luftëtarëve u dyfishua.

BRIGADA PATI KËTË INKURSION LUFTARAK:

Në ditët e fundit të muajit gusht 1944 forcat e saj organizuan një varg pritash kundër autokolonave armike në rrugën Berat-Lushnje. Me 2 shtator ato sulmuan nazistët gjermanë në Mbrostar dhe, pasi i shpartalluan, dogjën pesë depo me municion e material tjetër ushtarak. Gjatë luftimeve

këtu u zunë qindra pushkë, dhjetra mitralozë e municion i shumtë dhe radhët e brigadës u shtuan me qindra bij e bija të Myzeqesë.

Më 8 shtator 1944, një batalion i brigadës goditi një autokolonë prej 15 maqinash me nazistë gjermanë në rrugën Fier-Lushnjë. Me 13 shtator 1944 brigada sulmoi në befasi nazistët gjermanë brenda në ayetin e Fierit dhe preu rrugën Lushnjë-Fier-Vlorë. Pasi u shkaktoi dëme të mëdha armiqve, ajo u tërhoq në fshatrat për rreth Fierit.

Prej kësaj kohe dhe deri në dyjavëshin e parë të tetorit '44, forcat e Brigadës 16-të Sulmuese, të vendosura në pozicione luftimi gjatë rrugës Fier-Vlorë, Fier-Lushnje dhe Berat-Lushnje goditën pa rreshtur kolonat gjermane në tërheqje.

Me 15 Tetor 1944 forcat e Brigadës 16-të Sulmuese çliruan Fierin, ndërsa



më 20 Tetor një pjesë e tyre ndihmoi Brigadën e 8-të për çlirimin e Lushnjes. Armiku la mbi 100 të vrarë, shumë të plagosur dhe materiale luftarake.

Ne humbëm 56 partizanë trima. Lavdi të rënëve! Lavdi edhe atyre që vdiqën në liri po me ato ideale të Luftës!

Kur gjeneral Nexhip Vinçani përshëndeste krijimin e Brigadës XVII S

81 vjet më parë, me 26 shtator 1944, në vendin e quajtur Fushë e Kuqe, në fshatin Gjinar të Shpatit të Elbasanit, u formua Brigada e XVII Sulmuese Partizane. Në ditën e përfundimit, në përberjen e Brigades XVII-S u futën batalionet e qarkut të Elbasanit: Batalioni Dumre - Darsisë, i Shpatit "Naun Panxhi", i Bërzeshtes, i Verçë-Sulovës dhe ai i Polisit. U zgjodh fshati Gjinar sepse ai ishte në qendër të veprimeve luftarake të këtyre batalioneve.

Përveç këtyre u rreshtuan edhe 94 të rinj nga qyteti i Elbasanit dhe nga terreni. Pra brigada përbëhej nga 1592 partizanë, nga të cilët 1012 nga rrethi i Elbasanit, 282 nga rrethi i Librazhdit, 119 nga rrethi i Gramshit dhe pjesa tjetër nga rrethe të tjera. Mbi 90 % e partizanëve ishin nën moshën 25 vjeç.

Për drejtimin e Brigadës, në ditën e inaugurimit, u zgjodh shtabi i cili përbëhej nga Gjeli Argjiri - komandant; Qamil Guranjaku-komisar; Ndreçi Plasari-zv/komisar; Sefedin Meçe-zv/komandant; Nebi Agolli-pergjegjes rinie, Nexhdet Deveja -axhitprop; Shaqir Tabaku-intendent. Në shtabet e batalioneve komandantë e komisarë ishin respektivisht:

Në batalionin I të Dumresë; Petrit Hakani e Llambi Peçini,

Në batalionin II: Sami Leka e Beqir Dervina;

Në batalionin III, Veniamin Hazizi dhe Kadri Abdihoxha, në batalionin IV Muharrem Çota (Hoxhë Cota), Niko Dilo .

Në radhët e Brigadës së 17 S u rreshtuan edhe shoqe si Jolanda Xhuvani, Shegushe Hakani, Alipi Dedja, Burbuqe Gjergji, Emine Guranjaku, Ikbale bylyku, Parashqevi Gjini, Afërdita tërova, Hedije Tola, Diamante dilo, etj.. Pjesa më e madhe e këtyre shoqeve vinin nga fronti i luftës ku kishin marrë pjesë në veprime luftarake e kishin zhvilluar veprimtari të dendur politike.

Në ditën e inaugurimit në orën 11.00



Komisari i Brigadës Qamil Guranjaku i paraqiti forcën Zihni Muçës, sekretar politik i Qarkorit. Në emër të Shtabit të Përgjithshëm përshëndeti i deleguari i këtij Shtabi, Nexhip Vinçani i cili i dorëzoi flamurin e Brigadës 17-të komisarit Qamil Guranjaku.

Të nesërmen e krijimit të Brigadës u formua edhe Divizioni IV Sulmues dhe ajo u bë pjesë e këtij formacioni të madh luftarak dhe në përbërje të tij kreu veprime luftarake të shumta.

Përfjekja e parë me armikun u bë në Darsi të Peqinit me 2 tetor 1944, ku shpartalloi bandën balliste të Hamit Matjanit e çliroi krahinën duke vendosur pushtetin e këshillave Nac-Cl. Në këto luftime të ashpra ra në fushën e betejës partizani Rrahman Lato dhe u plagos komandanti i batalionit Muharrem Çota.

Me 5 tetor brigada sulmoi një autokolonë gjermane në rrugën Elbasan-Peqin ku iu shkaktuan armikut dëme të mëdha.

Pas këtyre veprimeve luftarake Brigada XVII u ngarkua të vepronte në rajonin e Qafes së Kërrabës, për të goditur postat dhe kolonat gjermane gjatë rrugës Elbasan-Tiranë dhe Elbasan - Peqin.

Nga 24 tetori 1944 deri me 16 nëntor 1944, brigada ka bërë 23 goditje kundër kolonave gjermane nga të cilat 9 janë bërë në rrugën Elbasan-Peqin dhe 14 goditje në rrugën Elbasan-Tiranë.

Me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm brigada u kthye në luftimet për çlirimin e Tiranës, duke u vendosur në Mullet e Lundër dhe me 13 nëntor 1944, kreu sulmin mbi autokolonën gjermane të grupit "Steyker", Qafë-Krrabë-Tiranë. Në Fikas e Ibë ajo së bashku me forca të tjera partizanë i shkaktoi armikut humbje të rënda. Në betejën e Mushqetas me 13-14 nëntor 1944 armiku u dëmtua rëndë prej luftës partizanë. Kur kryeqyteti ndodhej i rrethuar nga forcat partizane Brigada siguron te shpinen dhe krahët e tij. Në Mushqeta

rreth 1000 luftëtarë të Ushtrisë Nac-Cl u ndeshën me 3000 ushtarë hitlerianë në një luftë për jete a vdekje. Komandës armike i kishte mbeture 1000 hitlerianë të vrere dhe tok me to dhe dëme shumë të mëdha materiale. Pjesa e armiqve që mbeten gjalle u kapen rob.

Në keto luftime të ashpra rane heroikisht në fushën e betejës 11 luftëtarë të Brigadës XVII-S, midis të cilëve komisar i batalionit III, biri i lavdishëm i popullit të Elbasanit, intelektual Kadri Abdihoxha.

Brigada i kreu me nder detyrat e ngarkuara. Ajo shkroi si gjithë brigadat e tjera faqe lavdie dhe heroizmi. Ajo i dha lirisë 31 deshmorë për të cilët përulemi me nderim të thellë dhe do të kujtohen në jetë të jetëve për veprën e tyre sublime. Ajo është e do të jetë një shembull frymëzimi për pasardhësit e veteranëve, që të mbajnë gjallë përjetë atdhedashurinë e lavdinë e luftës partizane.

81-VJETORI

Rruga e lavdishme heroike e Brigadës së XVIII-të

Para 81 vitesh, më 18.8.1944, në Sllatinë të Dibrës u formua Brigada e XVIII S nga batalionet partizane të Dibrës, Çermnikës e Martaneshit, si dhe me vullnetarë të rinj nga krahinat e Dibrës, që u organizuan në katër batalione.

Komandat i Brigadës XVIII S. qe Esat Ndreu dhe zëvendëskomandant Zoi Themeli, komisar Miço Kallamata dhe zëvendëskomisar Sotir Vullkani.

Më pas, komandant brigade kanë qenë edhe Zoi Themeli e Petrit Dume, ndërsa zëvendëskomandant kanë qenë edhe Petrit Dume e Xhevdet Petrela. Komisar qe edhe Ilmi Çausholli dhe zëvendëskomisar qenë edhe Temo Sejko e Milo Qirko; përgjegjës rinie Dhori Shkodrani, sektori i Agjitpropit: Qazim Prishtina (përgjegjës) Muntaz Kodra, Servet Tershana; intendent: Mahmut Ndreu, Bardhyl Papajani, Kin Dushi, oficer i mbrojtjes Mustafa Novi, oficer informativ Sakip Luku, oficer në sektorin informativ Zenulla Uka (përgjegjës i seksionit). Brigada që në fillim, sipas detyrave që kishte marrë nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë NÇ, nën drejtimin e komandës sonë veprimi së bashku me Brigadat e I, IV, e të V Sulmuese për asgjësimin e sulmeve që ndërmerrnin forcat gjermane e bashkëpunëtorët e tyre, si ajo e mësymjes së tyre nga Hilma, por u shpartalluan dhe më 23 Gusht 1944 u çlirua Peshkopia dhe gjithë Dibra dhe kjo ditë u shpall dita e çlirimit të Dibrës.

Pas 30 Gushtit Brigada veprimi në luftimet kundra gjermanëve e bashkëpunëtorëve të tyre në Lumë, Kukës e Prizren...

Kukësi u çlirua më 18 Nëntor 1944 dhe së bashku me forcat e Brigadës V-të Sulmuese u çlirua Prizreni më 17 Nëntor 1944. Pas kësaj Brigadës iu caktua detyra për asgjësimin e mbeturinave të mercenarëve dhe bashkëpunëtorëve me okupatorët nazifashistë në zonën Mirditë-Pukë.

Për të gjitha këto luftime e aksione të Brigadës është botuar Historiku i Brigadës së 18-të Sulmuese (të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare), 18 Gusht -25 Prill 1945, në vitin 2008.

Sipas kujtime të Hajri Hoxhës, ish-partizan dhe kuadër i kësaj brigade (ish-komisar i kompanisë së shtabit të Brigadës): "Pothuajse çdo natë Batalionet e Brigadës zinin pusi në istikamet e improvizuara rreth rrugës Prizren - Kukës, poshtë fshatit Bardhoc e të tjerë deri në afërsi të Kukësit që prisnim autokolonën gjermane të tërhiqeshin nga Prizren-Kukës-Pukë-Shkodër. Po ashtu kishte javë që në ditë të caktuara për afro dy muaj batalionet me radhë ndërmerrnin aksione kundra forcave gjermane në qytetin e Kukësit. Këto jepnin rezultate në dëmtimet që u bënë si në njerëz e materiale autokolonave gjermane apo atyre të vendosura në qytet.

Dhe ne të gjithë partizanët në këtë rast ruajmë pritjen që si para apo pas aksionit të fshatrave të Kukësit që nga Bicaj e Morina ndanin bukën e tyre me ne e çfarë kishin në shtëpi si groshën, dhallë e sidomos turshitë dimërore, sepse po të mos ishte kjo nga do të merrnim ne bukën etj.

mos kishim magazinat me miell apo të tjerat? Jo, "magazinë" ishte zemra



bujare e fshatarësisë si kudo në gjithë popullin shqiptar e sidomos të fshatarësisë edhe në të Dibrës-Krumës-Kukësit-Pukës e Prizrenit".

Me çlirimin e Kukësit dhe Prizrenit u bënë ndryshime në udhëheqjen e Shtabit të Brigadës.

Esat Ndreu u caktua me forcat e

ndjekjes në Shkodër dhe Komandant erdhi Petrit Dume, ndërsa Komisar Hilmi Çausholli, sepse Miçua u caktua Komisar në një brigadë shqiptare në Maqedoni. Në këto ditë çlirimi të Kukësit Hajri Hoxha kujtonte ardhjen në Brigadën e XVII të 112 shokëve e shoqeve që kishin shpëtuar nga kam-

pi nazist gjerman i Prishtinës, ku disa prej tyre u rreshtuan në këtë Brigadë, si i paharruari Kin Dushi që arriti të emërohet edhe Komandant Batalioni. Ai ka shkruar dhe botuar në libër vuajtjet dhe pushkatimet e 105 të rinjve shqiptarë në këtë kamp më 23 Tetor 1944. Po ashtu Kini ka vlerësuar trimërinë e gjithë shokëve që ishin pushkatuar e në mes tyre përmend heroizmin e ish - partizanëve të Batalionit të Dibrës Spiro Velko, Musa Agolli e të rinjve të tjerë dibranë si: Bilal Konxholli, Tasim Shehu, Hamza Shehu. Pas çlirimit të Atdheut më 29 Nëntor 1944 Brigada e XVIII S, sipas Urdhrit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë NÇ, veprimi deri në Mars 1945 për asgjësimin e disa bandave mercenare të mbetura në zonat e Krumës, Mirditës dhe Pukës.

Partizanët e saj kanë qëndruar për disa kohë në Fushë-Arrëz. Pas kësaj në udhëtimet Lumë, Dibër, Gollobordë, Librazhd, Gramsh, Përmet, po sipas Urdhrit të Shtabit të Ushtrisë NÇ mbërritën në Gjirokastrë ku më 23 Prill 1945, efektivit i saj u bashkua dhe u rreshtua në një Brigadë me brigadën e 20-të Sulmuese.

Gjatë periudhës 2-mujore efektivit i brigadës i shkaktoi dëme të konsiderueshme armikut.

BRIGADA E 19-të S: Në një llogore kundër armiqve - shqiptarë e minoritarë

Brigada 19-të Sulmuese Partizane u krijua në Theollogo të Sarandës më 30 gusht të vitit 1944. Nga përbërja e partizanëve; shqiptarë e minoritarë dhe qëllimi i përbashkët, kjo është quajtur "Brigada e vëllazërimit", midis popullit shqiptar dhe minoritetit grek. Në Brigadën XIX u rreshtuan partizanë të batalioneve "Pandeli Boçari", Thoma Lulo, "Meteoti" (partizanë italianë) e Thanas Ziko, me një efektiv rreth 810 vetë të organizuar në 3 batalione. Komanda e Brigadës ditën e formimit të saj përbëhej nga këta kuadro: Komandant Andrea Nasi; komisar në fillim Vango Mitrojorgji e me pas Thoma Xhixho, zv/komandant Mehmet Dusha; zv/komisar Lefter Kasneci etj.

Populli i minoritetit grek, duke pasur besim në platformën e Frontit NÇL të udhëhequr nga PKS mori pjesë masive e aktive në LANÇ, luftoi për një jetë demokratike se do çlirohej nga robëria fashiste, nga regjimi antipopullor i Zogut, se do të siguronin lirinë e demokracinë dhe do t'i zgjidhnin drejt problemet e tij sociale.

Dhe ky besim u justifikua mbas çlirimit.

Brigada që nga dita e parë e formimit e deri në fund, ka zhvilluar luftime të ashpra kundër nazistëve gjermanë dhe bashkëpunëtorëve të tyre ballistë e zervistë, duke u shkaktuar atyre humbje të mëdha. Të tilla qenë luftime në Konispol, Delvinë, Qafë Bot, Muzinë, Pec, Zminec, Stugar, Dhrjovjan, Libohovë, Qafë e Kiçokut e shumë luftime të tjera.

Të paharruar do të mbetet lufta frontale e 55 ditëve për mbrojtjen e Konispolit nga forcat gjermane. Luftime të ashpra kreu Brigada 19 mbi garnizonin e Delvinës ku ishin përqendruar rreth 500 gjermanë dhe 300 ballistë. Në momentet e para u zunë rob 50 ballistë. Por në këtë luftë ranë heroikisht 21 partizanë e kuadro dhe u plagosën 22 të tjerë. Në këto luftime gjermanët bënë barbarizma dhe vandalizma nga më të ashprat mbi trupat e vvarë.

Brigada 19-të S mori pjesë në çlirimin e qytet-

eve Delvinë, Sarandë, Gjirokastrë. Ajo u angazhua në veprimet luftarake për goditjen e asgjësimin e garnizoneve të veçuara të pushtesit gjerman në zonën përreth kreu goditje të njëpasnjëshme ndaj autokolonave gjermane në rrugët lëvizëse drejt veriut, si dhe shpartalloi bandat e xhandarmërisë dhe të ballisto-legalistëve në këtë zonë të bregdetit jugor të vendit.

Më 1 tetor 1944, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë ANÇSH Brigada e 19-të kaloi në përbërje të Divizionit III së bashku me brigadat 12 dhe 14. Që nga 10 tetori i vitit 1944, iu ngarkua detyra e sigurimit të kufirit bregdetar Vlorë-Konispol dhe konsolidimit të pushtetit popullor. Miqësia që u gatua dhe u kalit në llogoret e luftës për liri u çimentua me gjakun e Polo Bezhanit, Llambro Nikës, Veliko Rexhës e Lejla Malos, Selfo Abedinit, Llambro Llambraqit,

Petro Anagnostit, Urani Bari, Jani Papa, Theodhori Mastora, Lefter Talo, Qirjako Dhroso e shume të tjerë që dhanë jetën në përpjekje me armiqtë. Në luftimet kundër nazistëve e bashkëpunëtorëve të tyre ranë heroikisht 73 partizanë e partizane dhe u plagosën 70 të tjerë ku mbetën invalidë një pjesë prej tyre.

Si për çdo njësi e brigadë partizane që u krijua gjatë LANÇ, edhe për Brigadën e 19-të Sulmuese, dita e formimit të saj mbetet një ngjarje e shënuar për popullin e zonës e rrethit ku ajo lindi, shqiptarë e minoritarë grekë, për Ushtrinë Nacionalçlirimtare dhe për historinë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në tërësi.

Është krijuar tashmë tradita e kthimit të kësaj date në një festë popullore, ku edhe një herë, shpaloset historia e lavdishme e LANÇ, ku kujtohen aksionet e luftërat e kësaj brigade kundër armiqve nazifashistë e bashkëpunëtorëve të tyre, kujtohen e nderohen me respekt ata që ranë në betejat për çlirimin e Shqipërisë, që mbetën yje të pashuar në panteonin e lavdisë, kujtohen gjithë luftëtarët e saj, sakrificat e panumërta të popullit.

Dhe nga përkujtimi i kësaj date historike, përcillet mesazhi i madh: mos e preknit epopenë e madhe të LANÇ, të ruhet e të forcohet vëllazërimi mes popullit shqiptar e minoritetit grek, që u çelikos në zjarrin e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare për çlirimin e Shqipërisë.

LIBRI

Flamur Micko dhe libri i tij për aviatorët shqiptarë “Midis qiellit dhe tokës mëmë”

“Midis qiellit e tokës mëmë” është vetë historia e aviacionit shqiptar



Nga Sakip Cami

Libri me kujtime “Midis qiellit e tokës mëmë” është vetë historia e aviacionit shqiptar

Libri i autorit Flamur Micko “Midis qiellit dhe tokës mëmë” përmban 432 faqe dhe shumë fotografi nga jeta partizane dhe ajo ushtarake. Vjen nën redaktimin e poetit dhe gazetarit të mirënjohur Lirim Deda dhe me reensë nga Prof. Kol. Bernard Zotaj.

Dashuria për Atdheun, për vendlindjen e tij Nivicën e Kurveleshit, dashuria për armën e aviacionit, të cilës ia kushtoi jetën, përshkruajnë të gjithë rreshtat e faqet e këtij libri voluminoz.

“I etur për dije e plot dashuri për vendin tim, në mars të vitit 1949 shkova për studime në Bashkimin Sovjetik dhe u ktheva në muajin gusht të vitit 1952, i diplomuar si pilot gjuajtës luftarak. Kur u ktheva në fshat m’u duke se më duartroktonin edhe vetë malet”, shkruan autori në hyrje të librit.

Libri hapet me poemën për fshatin e lindjes, Nivicën.

Po shkëpusim një fragment:

“...Sa kam bredhur pyjesh larg,
Nëpër re, mjegull, shi...
Nëpër natë unë fillik
Mëma larg, si Perëndi...”

Në 100 faqet e para autori përshkruan vendlindjen, fshatin, lagjet, malet, lëndinat dhe gjithcka ruan në kujtesën e tij. Përshkruan fëmijërinë e vështirë në fshat, shkollën e gurtë dhe mësuat e mrekullueshëm, prindërit që e mëkuan me dashuri dhe guxim.

Në prill të vitit 1943, kur ai ishte vetëm 14 vjeç në Kropisht vinë partizanët e cetës “Halim Xhelo, vinë drejtuesit e lëvizjes Nacionalclirimtare të zonës Arif Hasko, Et’hem Gjinushi, Delo Balili, Hito Cako, Rrahman Parlaku.

Eqerem Kreshpa nga Kanina më tha se ti je i vogël për në batalion, por për këtë vendosin komisar dhe komandanti. Unë e ndoqa cetën partizane nga pas dhe ata më pranuan, tregon Flamuri.

Në maj të vitit 1943 mua m’u besua flamuri i batalionit dhe që nga ajo ditë më thirrën Flamur, megjithëse e kisha emrin Avni.

Me 7 gusht të vitit 1943 në Cepo u krijuan Batalioni “Asim Zeneli” me komandant Jaho Gjolikun dhe komisar Shefqet Pecin.

Me 23 janar 1944, Flamuri do të rreshtohet në Brigadën e VI Sulmuese. Dhe si një histori e gjallë me një kujtesë për t’u admiruar Flamuri rendit partizanët e fshatit të tij, Nivicës: Avdul Muco Lopa, Balil Cerciz Bylyshi, Novrus Sheho Matushi, Novrus Reis Xhaka, Bylysh Dalan Koka, Flamur Selim Micko, Hysni Shaqo Bega, Isuf Teno Shehu, Mirjana Isuf Shehu, Pëllumb Veip Malo, Rexhep Cako, Rushan Murat Goxhi, Sali Tare Seferi, Selim Dervish Beqo, Liri Toska (Duka), Mejdi Bilo Mema.

Më tej Flamuri përshkruan të gjitha luftimet e Brigadës së VI në Jug dhe në Veri të Shqipërisë dhe pas clirimit të Shkodrës me 29 nëntor 1944, kalimin e brigadës në viset shqiptare në Ish Jugosllavi me komandant të Brigadës Jaho Gjolikun dhe komisar Xhule Cirakun.

Pas kthimit nga lufta në viset shqiptare të Ish Jugosllavisë në Prill të vitit 1945 Flamuri filloi Shkollën Ushtarake “Skënderbej”.

NËPËR FAQET E LIBRIT:

Kursantët e parë shqiptarë për aviator në Bashkimin Sovjetik

Me 7 mars 1948 nga Shkolla Skënderbej” nisët për në Bashkimin Sovjetik, grupi i parë për t’u përgatitur si pilot. Në stacionin e trenit ata u pritën nga Edip Ohri dhe Niko Hoxha, të cilët vijonin vitin e fundit në Shkollën e Bombarduesve “Maria Raskova” në qytetin Engels.


Më 10 mars 1948 u regjistruan kursantët e parë shqiptarë: Lulo Musai, Elmaz Hasamataj, Gani Selami, Refat Jazo, Shaqo Hoxha, Riza Ramadani, Hektor Lako, Qemal Mërtiri, Bajram Hitaj dhe Flamur Micko.

Në mars të vitit 1951 shkëputemi nga Shkolla “Maria Raskova” dhe shkojmë në qytetin Saratov në Shkollën e gjuajtësve luftarakë “Pokrishkin”(Tre herë hero i BS).

Pas diplomimit si pilot fluturues me avion gjuajtës bombardues më 31 gusht 1952 u kthyem në Atdhe, ku në Durrës na priste Edip Ohri dhe Niko Hoxha dhe ku u takuam edhe me grupin tjetër që kishin mbaruar studimet për gjuajtës luftarakë, Petrit Malindi, Kosta Dede, Lektor Stafa, Zebo Dyrmishi, Sulo Salo.

Në tetor të vitit 1952 me Urdhër të Komandantit të Përgjithshëm Enver Hoxha, të gjithë ne kursantët që kishin studiuar në B.S për aviator, u titulluam oficerë të Ushtrisë Popullore.

Në skuadriljen e aviacionit të sapokrijuar komandant ishte Niko Hoxha, komisar Edip Ohri, Zv.koman-



dant Babace Faiku, Shef Shtabi Fari Bubsii.

Fluturimin e parë, tregon Flamuri në qiellin e atdheut tim e kam bërë me Peco Polenën. U mahnita me bukuritë e natyrës sonë të mrekullueshme, me Liqenjtë e Lurës, me Ujvarën e pambarim të Valbonës, me bjeshkët e Veriut të rradhitura si fishekët në gjerdan, me Korabin që qëndron si busull orientimi në territorin e Veriut. Dhe më tej në Jug duket madhështor Olimpi shqiptar Tomorri legjendar, vatra e perëndive ilire, edhe ky busull orientimi për të tërë vendin.

NË SHKOLLËN E AVIACIONIT

Shkolla e Aviacionit është krijuar në vitin 1957 me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes Beqir Balluku, i cili vuri detyrë që të fillojë përgatitja e pilotëve pranë skuadriljes së Laprakës në Tiranë. Përgjegjës u caktua Major Areteo Konomi.

Në maj të vitit 1958 filloi praktika e fluturimit në aerodromin e Tiranës. Gjatë përgatitjeve një avion rrëzohet në aerodrom, por nuk pati viktima. Për siguri në korrik 1958 fluturimet vazh-

dojnë në fushën e Shijakut dhe kursantët mbarojnë programin e stërvitjes ajrore fillestare.

Kursantët që mbaruan programin mësimor në Shqipëri në gusht të vitit 1958 u dërguan jashtë shtetit, në ish Bashkimin Sovjetik.

Në “shkollë” vijnë kursantë të tjerë, përsëri një avion pësoi defekt, takoi me një pemë, njëri krah i avionit u copëtua, por piloti e kursanti shpëtuan.

1959 – “Shkolla” u vendos në Kuçovë. Komandanti i “shkollës” Thanas Gjijnuri.

1960 – maj. Filloi programi i përgatitjes së kursantëve për avionët reaktivë MIG-15.

Më 27 qershor, kursanti Jovan Kaçorri humbi jetën duke fluturuar mbi qytetin e Fierit. Në korrik, kursanti Petraq Qafëzezi u hodh me katapultë.

Ministri i Mbrojtjes Beqir Balluku, urdhëron të formohet “Shkolla e Aviacionit në qytetin e Vlorës”. Me 11 maj 1962 me dekret të Kuvendit Popullor zyrtarizohet krijimi i Shkollës së Aviacionit. Komandant i shkollës u emërua

Vijon në faqen 7

LIBRI

Flamur Micko dhe libri i tij për aviatorët shqiptarë “Midis qiellit dhe tokës mëmë”

“Midis qiellit e tokës mëmë” është vetë historia e aviacionit shqiptar

Vijon nga faqja 6

Babaçe Faiku.

Me datë 3 nëntor u diplomuan “Pilot gjuajtës-bombardues”, kursantët që kishin lënë përgjysëm studimet në ish-Bashkimin Sovjetik.

Në gusht të vitit 1966 u titulluan oficerë, kursantët e grupit të parë për “Teknik Aviacioni”. Në tetor të vitit 1966 u titulluan oficerë, grupi i parë i kursantëve për “Pilot gjuajtës –bombardues”. Në shtator të vitit 1967 u titulluan oficerë, grupi i parë i kursantëve për “Specialistë Aviacioni”. Në shtator të vitit 1972 shkolla e aviacionit u bë tre vjecare dhe kaloi në sistemin e shkollave të larta ushtarake dhe në sistemin e lartë arsimor të vendit. Më pas mori emërtimin: “Akademia e Aviacionit.

Flamuri në kujtimet e tij shkruan se, “Me një projekt të studiuar mirë nga komanda e MKA (Dega e Aviacionit) u krijua grupi drejtues me Përgjegjës kryesor Major Areteo Konomi, grupi inxhinier teknik drejtohej nga Jorgji Bitri, komandant katërshe Irakli Grazhdani, ndërsa instruktorë ishin Petrit Malindi, Refit Jazoi, Hektor Lako, Vasil Gjickondi, Agim Spahiu dhe Flamur Micko. Kursantët e vitit 1957-1958 ishin Aristotel Poga, Agron Galanzhi, Lili Laçka, Nestor Dhaskali, Bilal Josa, Ilija Kovaçi, Vangjel Nakuçi, Luan Sima, Thanas Naçi, Llazar Çupa, Iljaz Kelo, Pandi Buci, Vasil Kromidha, Skënder Kanina, Burhan Nurja, Gëzim Picari, Muharrem Hida, Nasa Leka, Aranit Tartari, Gaço Rrapi”.

Në përgatitjen teorike të lëndëve speciale dhanë mësim inxhinierët Andon Koroveshi e Kleanth Hanxhari, ndërsa teoria e fluturimit jepej nga ish-pilotët Andrea Stavri e Vasil Gjickondi. Gjatë muajit shkurt instruktorët përfunduan programin e përgatitjes metodike, ndërsa kursantët programin teorik, kështu që në pranverë të vitit 1958, në muajin maj filloi praktika e fluturimit në aerodromin e Tiranës.

Pas përplasjes së një avionit, që nuk pati viktima, si masë sigurie fluturimet vazhduan deri në korrik të vitit 1958 në fushën e Shijakut. Kursantët, pasi mbaruan programin e stërvitjes ajrore fillestare, në muajin gusht u dërguan jashtë shtetit. Një pjesë e tyre u dërguan për pilotë reaktivë në qytetin e Borisoglebsit, ndërsa të tjerë për të mësuar helikopterët Mi-1 e Mi-4, në qytetin e Pugaçovit”.

Në vitin 1958 në këtë “shkollë” shkuan kursantë të tjerë si, Ali Islami, Baftjar Meta, Bilush Imeri, Lirim Kokona, Myrteza Arapi, Petraq Qafëzezi, Kosta Dalla, Panajot Gjipopuli, Osman Allkja, Vasil Nikolla, Jovan Kaçorri, Atllan Buzo, Divin Abazi, Pandi Prifti, Raif Hozha, Servet Murati, Shuaip Nurja, Niko Qëndro, Robert Marku, Çerçiz Zeka, Sotir Majko, Muço Muçaj.

Kontingjenti i dytë i kursantëve prej 20 veta, në pranverë të vitit 1959



u shkëput nga reparti nr. 5818 dhe kaluan pranë Regjimentit të Kuçovës, së bashku me instruktorët. Komandanti i “shkollës” caktua piloti i Klasit I, Thanas Gjicknuri, i cili zëvendësoi Areteo Ikonomin. Vetë Gjicknuri sapo kishte dalë i paaftë për të fluturuar në aeroplanët reaktivë. Instruktorët ishin pothuajse ata që kishin qenë edhe në Tiranë, si Flamur Micko, Hektor Lako, Refit Jazoi, Petrit Majlindi, Irakli Grazhdani dhe Agim Spahiu. Aty nisën të përgatitjet për instruktorë të ardhshëm edhe Naun Todo, Admir Fllaga, Nehar Jazexhi, Hamdi Arapi, etj.

Kursantë të këtij grupi ishin Jovan Kacorri, Baftjar Metaj, Bilush Imeraj, Sotir Majko, Robert Marko, Petraq Qafëzezi, Lirim Kokona, Servet Muka, Servet Murati, Divin Abazi, Çerçiz Zeka, Raif Hoxha, Shuaip Nurja, Vaskë Nikolla, Nuço Muçaj, Myrteza Arapi, Atllant Buzo, Niko Qëndro. “Shkolla” kishte një skuadrile me aeroplanë mësimorë me helikë Jak-18A, që ishte më i përparuar se Jak-18U, me të cilin fluturuar në fushën e Shijakut dhe në atë të Laprakës.

Në skuadriljen mësimore, në “shkollë”, gjithnjë në përbërje të regjimentit “Peza”, erdhi një grup tjetër kursantësh për pilotë, në përbërje të të cilit ishin edhe Sillo Mlica, Lili Xharo, Agim Ismaili, Vaso Pesha, Sazan Abibi, Thanas Papa, Bardhyl Lubonja, Bahri Meshau, Koço Biku, Lutfi Islamaj, Rrapo Kodheli. Në grupin e instruktorëve për avionët reaktivë ishin Tomorr Avdia, që kryente detyrën e komandantit të kësaj Skuadrile, ishin

Hamdi Arapi, Sali Dibra, Agim Spahiu, Sokrat Prifti dhe Hektor Lako. Në dimrin vitit 1959-1960, kursantët për pilotë iu nënshtruan programit teorik, ku përvehtësuan veçoritë e konstruksionit dhe shfrytëzimin e aeroplanit reaktiv Mig-15. Të dy grupet stërviteshin, sipas programeve të ndryshëm. Avionët me helikë Jak-18A fluturonin në fushën me bar të aerodromit të Kuçovës, ndërsa në qershor, kursantët që do të fluturonin në aeroplanët Mig-15, i sistemuan në rajonin e Pishë Poros.

Për këtë periudhë të përgatitjes së pilotëve pa patur ende një shkollë “zyrtare” shqiptare, Edip Ohri, ka theksuar se “fillimisht unë vura detyrë për përgatitjen e pilotëve pranë skuadriljes së Laprakës. Në vitin 1958 filloi fluturimi në aerodromin e Tiranës dhe më vonë në fushën e Shijakut. Në vitin 1959 i kalova në Kuçovë, por edhe atje u ndërpre. Në vitin 1962 si institucion më vete shkolla filloi në Vlorë me kurset për teknikë dhe pilotë”.

Flamuri kujton se, “gjatë dimrit 1959 e pranverës 1960 ata përvetësuan programin teorik të avionit e motorit të MIG-15. Po atë kohë u duk qartë se ky grup nuk do të shkonte në ish-B.S. Ata do të përgatiteshin në vendin tonë, në aerodromin e Kuçovës dhe në Pishë Poro. Ky ishte një zotim e iniciativë e vetë Edip Ohrit e Niko Hoxhës, të cilët premtuan se brenda dy vjetëve aviacioni shqiptar do të kishte të gatshëm e të përgatitur njëzet pilotë të rinj”.

Nën drejtimin e instruktorëve Petrit Malindi, Nehar Jazexhiu, Naun Todo, Admir Fllaga stërviteshin kursantët



Bardhi Lubonja, Agim Ismaili, Lili Xharo, Bahri Meshau, Syrri Barbullushi, Vaso Pesha, Sazan Habibi, Rrapo Kodheli, Thanas Papa, Koço Biku, Lutfi Islami, Sillo Mlica.

Në maj 1960 filloi realizimi i programit për MIG-15. Skuadrilja reaktive kishte komandant Tomorr Avdinë, ndërsa instruktorë ishin Sali Dibra, Sokrat Prifti, Hamdi Arapi, Agim Spahiu. Kursantë ishin Baftjar Metaj, Lirim Kokona, Servet Murati, Çerçiz Zeka, Bilush Imeri, Pandi Prifti, Muço Muçaj, Jovan Kaçorri, Petaq Qafëzezi, Raif Hozha, Sotir Majko, Alis Islami, Niko Qëndro, Divin Abazi, Atllan Buzo.

Një jetë në aviacion si pilot dhe 16 vjet si intruktur fluturimi në Shkollën e Aviacionit. Një jetë midis Qiellit dhe tokës mëmë.

KUSH ËSHTË FLAMUR MICKO?

Është lindur me 23 prill të vitit 1929 në fshatin Nivicë të Kurveleshit të Sipërm të Tepelenës. Mësimet e para i mori në vendlindje.


Në moshën 15 vjecare iu bashkua luftës antifashiste nacional clirimtare në fillim në batalionin “Perlat Rexhepi dhe më pas në Brigadën e VI Sulmuese. Në batalionin partizan ishte flamurm-bajtës, ndaj i thirrën Flamur.

Pas mbarimit të luftës dhe të luftimeve në Ish Jugosllavi fillon Shkollën Ushtarake “Skënderbej” në Tiranë. Mban medaljet e trimërisë, kujtimin, clirimit dhe të 10 vjetorit të ushtrisë. Në përfundim të Shkollës Ushtarake “Skënderbej” në vitin 1948 shkon për studime ushtarake për aviator në Bashkimin Sovjetik ku ndjek Akademinë e Pilotëve reaktivë dhe në vitin 1952 diplomohet për pilot avionësh reaktivë.

Me krijimin e Shkollës së Aviacionit në Tiranë dhe më pas në Kucovë dhe në Vlorë shërben si instruktor fluturimi për përgatitjen e pilotëve të ri shqiptarë. Është ndër pionierët e parë të Aviacionit shqiptar dhe ndër krijuesit e Shkollës së Aviacionit në Shqipëri.

REFLEKSIONE

Kontributi i Ushtrisë Shqiptare në luftën për çlirimin e Kosovës



Nga Bashkim Hisari

Gjatë luftës për çlirimin e Kosovës, angazhimi politik ushtarak dhe humanitar i Shqipërisë ishte njëmbështetje e madhe. Që nga fillimi i viteve 90-të qeveria dhe ushtria shqiptare u aktivizua në mënyrë të drejtpërdrejtë në çështjen e Kosovës. Deklaratat e autoriteteve Shqiptare dhe Kosovare, bashkë me një gamë të gjerë të dokumenteve zyrtare, foto të dëshmorëve, relikte, armatime, veshje, pastaj dëshmitë për mirëpritjen e shqiptarëve të dëbuar me dhunë dhe dokumente e fakte të tjera dëshmuar kontributin e jashtëzakonshëm të Qeverisë dhe Ushtrisë Shqiptare për çlirimin e Kosovës.

Në vitin 1991, Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Shqipërisë urdhëroi dikasterin e mbrojtjes që të ndihmoheshin djemtë e Kosovës me gjithçka të mundshme për t'u stërvitur ushtarakisht e për t'u armatosur me qëllim që të zhvillonin luftën çlirimtare në Kosovë.

Dy grupet themeluese të luftëtarëve të UÇK-së, në Shqipëri erdhën nga tremujori i katërt i vitit 1991. Grupi i parë ishte grupi i Zahir Pajazitit, i cili u përgatit në Elbasan dhe përbëhej nga rreth 54 veta. Ndërsa grupi i dytë 34 veta kryesohej nga Adem Jasharit dhe u përgatit në Tiranë, përkatësisht në Surrel, në malin e Dajtit.

Luftëtarët e Kosovës të cilët ishin të përkushtuar në çështjen e lirisë gjetën mbështetje në Shqipëri, krijuan baza të sigurta, qendra ilegale stërvitjeje, bënë furnizimin me armë.

Vendimi i Qeverisë Shqiptare më datë 12 tetor 1998 për të vënë në dispozicion të NATO-s të gjitha bazat ajrore e detare, hapësirën ajrore dhe rrjetin rrugor, ishte një vendim tepër i rëndësishëm historik. Ky vendim, i marrë për Kosovën, e shndërronte Shqipërinë në bazë ushtarake të NATO-s, për një sulm të mundshëm kundër Serbisë. Vendimi i guximshëm ishte një akt që e angazhonte Shqipërinë drejtpërdrejt në luftë me Serbinë, përkrah NATO-s. Divizioni i Kukësit gjendej në skalion të parë dhe në drejtimin kryesor të mbrojtjes së

Shqipërisë. Ky divizion u bë mbështetje e sigurtë e shpinës së luftëtarëve të UÇK-së

Qeveritë shqiptare, pavarësisht ndërrimeve politike të brendshme, shfaqën një qëndrim të njëjtë në mbështetje të të drejtave të shqiptarëve të Kosovës për vetëvendosje. Diplomacia shqiptare ushtroi presion dhe lobim të vazhdueshëm në organizata ndërkombëtare si OKB, OSBE dhe Këshilli i Evropës, duke dëshmuar shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut nga regjimi serb në Kosovë.

Përfaqësuesi shqiptar në OKB në shtator 1990, paralajmëroi Bashkësinë Ndërkombëtare se shqiptarët e Kosovës nuk kërkojnë asnjë të drejtë më shumë nga ç'kërkojnë popujtë e ish-Jugosllavisë.

Ushtria shqiptare ishte pararojë e UÇK-së

Ish-shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe ambasador i Shqipërisë në Slloveni e Kroaci, Pëllumb Qazimi theksoi se ushtria shqiptare gjatë luftës në Kosovë ka pasur një rol të jashtëzakonshëm dhe thelbësor në mbrojtjen e refugjatëve në kufi, në bashkëpunim me UÇK-në dhe NATO-në dhe garantoj sigurinë në kufirin shqiptaro-shqiptar.

Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm e ndihmuan dhe mbështetën Divizionin e Kukësit i cili udhëhiqej nga gjenerali Kudus Lamë. Ky divizion ushtarak ishte i dislokuar përgjat vijës kufitare të Kosovës pikërisht aty ku ushtria Jugosllave ishte përqendruar kohë më parë e që herë pas here provokonte me thyerjen e integritetit shtetëror Shqiptar duke goditur me artileri fshatrat kufitare të Shqipërisë. Ky Divizion u hodh në dispozicion të gjendjes duke i ngritur dhe mobilizuar ushtarët në gatishmërinë më të lartë morale taktike luftarake dhe psikologjike kombëtare. Divizioni i Kukësit dha një kontribut të çmueshëm në luftë të drejtpërdrejtë në kuadër të operacionit "Shigjeta" i cili u organizuar nga UÇK-a në të cilën morrën pjesë edhe shumë civilë nga fshatrat të brezit kufitar Shqipëri-Kosovë.

Gjatë periudhës kohore 22 muajsh përgjat vijës kufitare Shqipëri-Kosovë janë zhvilluar luftime të ndryshme prej atyre më të vogëla e deri te betejat disa orëshe e ditësh. Disa nga luftimet e zhvilluara në mes ushtrisë Shqiptare dhe srbo/Jugosllave ishin: 6 beteja në rajonin e Padeshit, 3 në Kamenicë, 2 në Stobërdë, 3 në Zherkë, 9 në Qafë Prush, 4 në Pogaj, 3 në Dobrunë, 2 në Morinë dhe disa të tjera në Koshare.

Ushtria shqiptare ishte pararojë e UÇK-së.... Kuadrot të ushtrisë shqiptare morën detyrë të përgatisnin dy grupet themeluese të luftëtarëve të UÇK-së. Djemtë e vajzat e Kosovës të ardhur edhe nga Perëndimi si

luftëtarë të UÇK-së, mbi 2 mijë e 500 luftëtarë u trajnuan në qendrën stërvitore në Mollas të Burrelit.

Paralelisht me kontributet tjera shumëdimensionale Shqipëria i kushtoi një kujdes të veçantë problemit të shqiptarëve të zhvendosur në Shqipëri. Sistemoi dhe u përkujdes për shumicën e 848 mijë shqiptarëve të dëbuar me dhunë nga Kosova. Mbi 100 djemë e vajza nga Shqipëria në luftën e fundit të Kosovës, humbën jetën në vijën e parë të frontit në kufirin Shqipëri-Kosovë, ndër të tjerët Xhevahir Selmani, Avdyll Trezhnjeva, Bylbyl Breçani, Hysni Neziri, Din Koleci e shumë të tjerë.

Një kontribut të rëndësishëm në luftën e Kosovës dhanë banorët e Tropojës. Që nga fillimi i luftës shumë të rinj tropojan u rreshtuan në radhët e UÇK-së. Mbështetje të çmuar dhanë në betejën e Koshares duke bërë të mundur thyerjen e kufirit shqiptaro-shqiptar dhe shëmbjen e piramidave një herë e përgjithmonë mes shqiptarëve. Ndihej më madhe për UÇK-në tropojanët kanë dhënë në furnizimin me armatim dhe municion në thellësi të territorit të Kosovës. Shumë prej tyre kanë ra në mina dhe në luftë me forcat serbo/jugosllave. Disa janë vrarë, disa janë plagosur dhe disa janë zënë rob dhe janë torturuar dhe gjymtuar në burgjet serbe.

Banorët e dy ish komunave Tropojë e Vjetër dhe Bytyç, ndihmuan në sigurimin e krahut të formacionit luftarak të UÇK-së për mos lejimin e krahmarjes nga forcat serbo/jugosllave, si dhe në asgjësimin e pykzimit të forcave të tyre.

Sipas një raporti të kryetarit të komunës së Tropojës Isa Memaj të datës 20 shkurt 2003 viktimat dhe të lënduarit nga Tropoja janë: Suela Alijaj, Shpëtim Sylaj, Agim Treshnjeva, Isa Qerrimi. Musafë Dermishi, Ismet Sylaj, Grair Bardhai, Ardian Hyka, Kreshnik Hyka, Përparim Neziri, Gjane Neziri. Isë Çelaku, Abedin Gosturani, Selim Demushi, Ardian Berisha, Agron Mulaj, Safet Rrustaj, Rexhep Treshnjeva, Shkëlqim Madani, Shaqir Kuçana. Isa Qelia, Besnik Qelia, Vasil Hyka, Elidon Pali, Vendim Demaj, Mustaf Demaj, Idriz Naka, Pëllumb Bashi, Hysni Neziri, Fatmir Sallahu, Rrush Sallahu, Astrit Baçi, Hasime Pitomina, Eduart Leci, Bashkim Neziri, Skender Memaj, Përparim Neziri, Xhevat Neziri, Xhemajl Iberhasaj, Ilir Gosturani, Kujtim Gosturani, Edmond Hajdari, Kreshnik e Luan Hajdari, Granit Hajdari, Ermal Osmani, Idriz Hoxha, Sherif Mella, Zajë Çela, Arbër Kuca, Senila Qelaposhi, Manushaqe Qelaposhi, Nezir Kuliçi, Halil Dermishi, Idriz Jahaj, Riza Haxhiaj, Adem Merturi, Fatjon Çela, Shpend Demaj, Kastriot Demaj, Avni Memaj Mujë Dautaj, Bledar Quriqi, Halil Demaj, Kastriot Demaj, Avni Memaj, Sadri Kuca, Rrustem Koeli, Skifter Kuca, Naim Boshnjakuj, Ferdinand Leci, Hamit Sallahu, Kuj-

• *Ushtria shqiptare ishte pararojë e UÇK-së.... Kuadrot të ushtrisë shqiptare morën detyrë të përgatisnin dy grupet themeluese të luftëtarëve të UÇK-së. Djemtë e vajzat e Kosovës të ardhur edhe nga Perëndimi si luftëtarë të UÇK-së, mbi 2 mijë e 500 luftëtarë u trajnuan në qendrën stërvitore në Mollas të Burrelit. Paralelisht me kontributet tjera shumëdimensionale Shqipëria i kushtoi një kujdes të veçantë problemit të shqiptarëve të zhvendosur në Shqipëri. Sistemoi dhe u përkujdes për shumicën e 848 mijë shqiptarëve të dëbuar me dhunë nga Kosova*

tim Sallahu, Sami Sallahu, Trashigim Hukaj, Sami Hukaj, Artur Halilaj, Agim Isaku, Edmond Sallahu, Sokol Haxhijaj, Osman Kortoçi, Haki Memaj, Ilir Kortoçi, Musa Vlladi, Eduard Hajdarmataj, Shkelzen Tabaku, Kujtim Nakaj, Melser Rexhaj, Arbër Hajdarraj, Endrit Rexhaj, Rrustem Sallahu, Aranit Kuçana, Ramadan Doçi, Kastriot Dega, Tahir Hoxha, Orion Qelia, Erlind Dautaj, Dritan Lushaj, Hysen Mellaj, Osman Selimaj, Renti Ismailgeci, Man Sallahu, Hyre Demiraj, Xhemile Sallahu, Ramë Sallahu.

Shumë personalitete të Shqipërisë ishim bashkë me popullin e Kosovës në periudhat më të rënda për kombin tonë dhe kontribuan për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Presidenti Meidani kryeministrat Nano, Majko, Meta, dhanë ndihmë të madh për çështjen kombëtare. Për kontributin e çmuar dhe përkrahjen e pakursyer për çlirimin e Kosovës, Asambleja komunale e Drenasit shpalli Pandeli Majkon "Qytetar nderi".

MIRËNJOHJA DHE NDERIMI PËR DR. YLBER VATËN

Doktorin nga Shqipëria me një karrierë brilante në fushën e shëndetësisë, njëri ndër kirurgët më të njohur në rajon, Ylber Vatën, qytetarët e Kosovës e njohën qysh nga pranvera e vitit 1999. E njohën nga momentet më të vështira të jetës së tyre kur u larguan me dhunë nga Kosova. Në ato kohëra të vështira të kombit kur të gjithë qytetarët e Kukësit dhe të Shqipërisë me veprat e tyre konfirmuan mikpritjen, dashurinë

CEREMONIA

Luftoi dhe dha jetën për Kosovën, heroit kombëtar Indrit Cara nderohet në 54-vjetorin e lindjes me një ceremoni

Nderimi për heroin Indrit Cara në përvjetorin e lindjes së tij

Në Ministrinë e Mbrojtjes u zhvillua një ceremoni solemne në kujtim të 54-vjetorit të lindjes së dëshmorit të Kosovës, Indrit Cara.

Në sallën e Ministrisë së Mbrojtjes, më 16 korrik, u mbajt një ceremoni përkujtimore për heroin kombëtar Indrit Cara, në nder të 54-vjetorit të lindjes së tij. Cara, i lindur në Kavajë më 1971, është një nga figurat më të spikatura të luftës për çlirimin e Kosovës, duke dhënë jetën në vitin 1999 në betejën e Gallushës në Suharekë.

Në këtë ceremoni, e cila u mbush me emocione dhe krenari, personalitete të njohura dhe përfaqësues të shoqatave patriotike vlerësuan veprën dhe sakrificën e Indrit Carës.

Ai kishte lënë emigracionin në Londër për t'iu bashkuar luftës çlirimtare, duke u shndërruar në një simbol të vendosmërisë dhe dashurisë për atdheun.

Adem Ajdini, kryetar i Shoqatës “Skënderbej”, e përshkroi Indritin si një luftëtar me shpirt të madh, i cili u kthye në Kosovë për të luftuar për lirinë. “Sot e nderojmë si hero, një figurë që përfaqëson ndërgjegjen tonë historike,” u shpreh Ajdini në fjalën e tij.

Një ndër momentet më prekëse ishte fjala e kolonel Besim Gashit, i cili theksoi se Indrit Cara nuk u përgjigj vetëm një thirrjeje, por bëri një zgjedhje të madhe në emër të popullit shqip-

- ***Përkujtimi i 54-vjetorit të lindjes së Indrit Carës nuk ishte thjesht një ceremoni nderimi, por një thirrje për të mos harruar ata që u flijuan për lirinë. Figura e tij mbetet një referencë morale për brezat e rinj dhe një shtyllë e identitetit tonë kombëtar***

tar. “Ai është biri i Shqipërisë dhe i Kosovës, një figurë që do të jetojë përjetë në memorien tonë,” tha Gashi.

Pjesë e aktivitetit ishin edhe përfaqësues nga Kukësi, të Shoqatës “Malziu”, të cilët nderuan Indritin me një certifikatë mirënjohjeje. Në sallë u lexuan poezi dhe u kënduan këngë kushtuar heroit, përfshirë këngën “Mora fjalë” të Shkurte Fejzës, që u kthye në një himn të shpirtit kombëtar.

Familjarët dhe bashkëqytetarët e Indritit ndanë kujtime prekëse. Adhurim Cara deklaroi: “Indriti nuk është vetëm pjesë e jona, por e gjithë Shqipërisë.

Ai është një simbol i pastër i guximit dhe atdhedashurisë.”

Fjalët më të ndjera erdhën nga familjarët e heroit dhe bashkëqytetarët e tij. Nga Kukësi, përfaqësues të Shoqatës “Malziu” nderuan kujtimin e tij me një certifikatë mirënjohjeje,

është simbol i guximit, i idealizmit, dhe i atdhedashurisë së pastër. Kujtimi i tij është pjesë e historisë sonë kombëtare”, thotë Adhurim Cara.

Kënga “Mora fjalë” nga Shkurte Fejza u këndua si një himn për veprën e atyre që ranë për lirinë. Përkujtimi i 54-vjetorit të lindjes së Indrit Carës u shndërrua në një manifestim kombëtar krenarie dhe reflektimi.

Përkujtimi i 54-vjetorit të lindjes së Indrit Carës nuk ishte thjesht një ceremoni nderimi, por një thirrje për të



ndërsa aktiviteti u shoqërua me poezi, këngë kushtuar Indritit dhe emocione të thella që përshkuan sallën.

“Indriti nuk ishte vetëm i yni. Ai

mos harruar ata që u flijuan për lirinë. Figura e tij mbetet një referencë morale për brezat e rinj dhe një shtyllë e identitetit tonë kombëtar.

Kontributi i Ushtrisë Shqiptare në luftën për çlirimin e Kosovës

Vijon nga faqja 8

vëllazërore dhe kujdesin që shqiptarëve të dëbuar mos të mungoi asgjë nga të gjitha aspektet, duke siguruar strehim ushqim dhe mjekim. Dr. Ylber Vata sfidoi limitet shkencore për t'iu shkrirë ato në humane, trajtoi, mjekoi, kuroi dhe shpëtoi jetën e shumë burrave, grave fëmijëve kosovar të plagosur nga forcat serbo/jugosllave gjatë intervenimit të NATO-së dhe luftës së UÇK-së. Në ato çaste dr. Ylber Vata ishte njëri ndër mjekët që shërbente në spitalin e Kukësit dhe gjendej në çdo mjedis. Ai nuk kurseu mundin, as djersën, as angazhimin e as dashurin për Kosovën dhe 24 orë ishte në shërbim të tyre në çdo vend.

Në shenjë respekti dhe falenderimi për dr. Ylber Vatën, Asambleja Komunale e Prizrenit miratoi vendimin për dhënien e titullit “Qytetar Nderi i Prizrenit”.



REPORTAZH

Stublla – Fshati i historisë, arsimit dhe shpirtit të mërguar

Nga Rajmonda Maleçka

Në zemër të komunës së Vitisë, aty ku rrugët e historisë, fesë dhe atdhedashurisë kryqëzohen, ndodhet Stublla – një fshat i vogël në sipërfaqe, por i pamasë në vlera. Në pamje të parë, ai të duket si një vendbanim i qetë, me kodra të buta dhe një klimë që fton për të qëndruar.

Por poshtë kësaj qetësie, fshihet një trashëgimi e pasur historike dhe një shpirt kolektiv që ka ditur të mbijetojë me dinjitet nëpër kohë të vështira.

Stublla ka rreth 700 deri në 800 shtëpi dhe një popullsi të regjistruar prej afro 5000 banorësh.

Sot, në fshat jetojnë rreth 600 vetë, ndërsa pjesa tjetër ndodhet në mërgatë – në shtete të ndryshme të Evropës, nga Zvicra në Gjermani, nga Austria në Suedi, e deri në kontinentin amerikan. Por largësia fizike nuk e ka zbehur lidhjen me vendlindjen. Përkundrazi – e ka forcuar. Çdo vit, në ditë feste apo gëzimi, Stublla gjallërohet nga zërat e bijve dhe bijave që kthehen për ta prekur sërish tokën e trashëguar.

Në historinë e arsimit shqip në Kosovë, Stublla zë një vend të veçantë: aty u hap shkolla e parë shqipe në kohën e okupimit, kur mësimi në gjuhën amtare ndalohej dhe dija në shqip konsiderohej kërcënim për sundimin. Ishte një akt guximi dhe besimi, një thirrje ndaj të ardhmes.

Sot, ajo shkollë është muze dhe dëshmi e gjallë se shqiptarët kanë ditur të mbrojnë gjuhën dhe identitetin me libra në dorë. Në të ruhen libra, dokumente, objekte shkollore – të gjitha dëshmi të një epoke që nuk duhet harruar.

Struktura shoqërore e Stubllës është gjithashtu unike. Fisi Gashi përbën shtyllën e këtij komuniteti, i njohur për traditat e forta dhe ruajtjen me fanatizëm të zakoneve të trashëguara. Por bashkë me të, në Stubllë janë pjesë e gjallë e jetës edhe fiset Kryeziu, Berisha, Krasniqi dhe Ballaban. Kjo përbërje ka ruajtur një ekuilibër të natyrshëm shoqëror dhe ka ndihmuar në kultivimin e një kulture të bashkëjetesës, solidaritetit dhe krenarisë.

Në qendër të jetës shpirtërore të fshatit qëndron Kisha e Shën Jozefit, një monument me vlerë historike e fetare.

Është më shumë se një objekt i kultit – është një urë mes brezave, një vend takimi i shpirtit me rrënjët. Në oborrin e saj ndodhet varri i Dom Zef Ramajt, klerik i devotshëm dhe një figurë që ruan lidhje të veçanta me jetën e Nënë Terezës. Besimi dhe arsimit, tek Stublla, kanë ecur gjithmonë bashkë – si dy shtylla që e kanë mbajtur të fortë këtë komunitet në kohë ndryshimesh të mëdha.

SHKOLLA E PARË SHQIPE NË KOSOVË – STUBLLA, DJEPI I DIJES DHE GUXIMIT

Në histori, ka vende që mbeten përherë si gurë themeli të identitetit kombëtar – dhe Stublla është padyshim një prej tyre. Në vitet kur Kosova ndodhej nën sundimin e Perandorisë Osmane, dhe kur gjuha shqipe ishte e ndaluar, pikërisht në Stubllë u ndërta Shkolla e Parë Shqipe në Kosovë – një akt i jashtëzakonshëm guximi, që u bë simbol i rezistencës kulturore dhe arsimore të shqiptarëve.

Kjo shkollë, tashmë e shndërruar në muze, ruan ende frymën e ditëve të saj të para.

Brenda mureve të saj modestë, 42 nxënës ndoqën mësimet nga 10 mësues shqiptarë, në një kohë kur çdo hap drejt dijes në gjuhën amtare konsiderohej akt rebelimi. Sot, klasat ruajnë strukturën e dikurshme, ndërsa në brendësi ekspozohen dokumente historike, libra të autorëve shqiptarë që janë përdorur në atë kohë, si dhe artefakte të çmuara që flasin për përkushtimin ndaj arsimit dhe gjuhës shqipe.

Zgjedhja për ta hapur pikërisht në Stubllë nuk ishte rastësore. Dokumentet tregojnë se ky vend ishte zgjedhur për faktin se regjioni nuk banohej nga turqit dhe ishte jashtë vëmendjes së Perandorisë Osmane. Kjo u dha nismëtarëve një mundësi për të zhvilluar shkollën me më pak rrezik, por me një ndikim të madh kombëtar.

Shkolla sot është më shumë se një monument historik – ajo është simbol i edukimit si akt i lirisë dhe kujtesë kolektive për brezat e rinj. Ajo dëshmon se dija ka qenë gjithmonë një nga shtyllat e mbijetesës kombëtare dhe se fshati Stubllë nuk është thjesht një vendbanim, por një djep i shpirtit arsimor të shqiptarëve të Kosovës.

PËRSHËNDETJE PËR STUBLLËN – NË FSHAT DHE NË MËRGATË

Një përshëndetje e ngrohtë shkon për të gjithë banorët e Stubllës – qoftë ata që ruajnë tokën dhe traditat në vendlindje, qoftë ata që jetojnë larg, në mërgatë. Ju falënderoj për dashurinë dhe përkushtimin tuaj që e mbajnë gjallë këtë vend dhe identitetin e tij.

Stublla është simbol i forcës së bashkimit dhe i dashurisë që nuk njihë distanca. Të gjithë së bashku, si komunitet, mbani gjallë historinë dhe shpresën e një të ardhmeje më të mirë.

MESAZHI I TË RINJVE TË STUBLLËS: PËRGJEGJËSI, KRENARI DHE SHPRESË PËR TË ARDHMEN

Ne, të rinjtë e Stubllës, mbajmë me krenari historinë e fshatit tonë dhe trashëgiminë e pasur që na kanë lënë paraardhësit. E dimë se rrugët që kanë kaluar gjyshërit dhe prindërit



tanë nuk kanë qenë gjithmonë të lehta – luftërat, largësitë dhe sfidat ekonomike na kanë përballur me shumë prova.

Por gjithmonë kemi qenë të bashkuar, me zemër e mendje për tokën tonë.

Sot, me sfidat e kohës moderne, ne jemi përgjegjësitë që do të mbajmë gjallë gjuhën, traditat dhe vlerat që na kanë formuar. Nuk është thjesht një detyrë, por një nder i madh që të jemi pjesë e këtij komuniteti.

Ne duam të tregojmë që, edhe pse shumë prej nesh jetojnë larg, në mërgatë, lidhja me Stubllën nuk është aspak e thyer. Përkundrazi, ajo është lidhja jonë më e fortë, motivi që na mban të bashkuar edhe kur jemi larg njëri-tjetrit.

Ne besojmë se arsimit është çelësi i çdo përparimi.

Për këtë arsye, jemi të përkushtuar të mësojmë, të zhvillojmë veten dhe të sjellim dije të reja që do të kontribuojnë në zhvillimin e vendit tonë. Shkolla e Parë Shqipe në Stubllë është shembulli më i qartë i dëshmisë sonë se arsimit dhe kultura janë themelet mbi të cilat ndërtohet çdo shoqëri e fortë.

Ne duam të ndërtojmë një të ardhme ku brezat e rinj do të kenë mundësi për jetë të mirë, ku do të mund të zgjedhin të qëndrojnë apo të kthehen në vendin e tyre, pa u ndjerë të detyruar të largohen. Një vend ku puna, respekti dhe bashkëpunimi do të jenë vlera të përbashkëta.

Ne besojmë në fuqinë e bashkimit –



midis fshatit dhe mërgatës, midis brezave të vjetër dhe atyre të rinj. Vetëm duke qëndruar bashkë, duke mbajtur gjallë gjuhën dhe kulturën, mund të sigurojmë që emri i Stubllës të jetojë edhe për shumë breza që vijnë.

Në fund, duam t'i falënderojmë të gjithë ata që punojnë për këtë vend – banorët në fshat, mërgatën, familjet që ruajnë traditat, dhe ata që mbajnë gjallë kujtesën tonë historike. Me punë dhe përkushtim, ne të rinjtë e Stubllës jemi gati të marrim përgjegjësinë për të mbajtur të ndezur flakën e identitetit dhe të ardhmes sonë.

Stublla është më shumë se një vend – është shtëpia jonë, dhe ne do ta mbajmë atë gjithmonë.

ESSE

Kulla që mban vulën e luftës

Nga Nexhbedin Basha

Gazetar & Poet

Kulla e familjes Basha në fshatin Shimçan mban me krenari pllakën: “Kjo shtëpi ka qenë bazë e LANÇL”, sepse gjatë korrikut dhe gushtit të vitit 1944, u kthye në bazë luftime dhe spital për partizanët e plagosur të Batalionit IV të Brigadës V Sulmuese, me komandant Sali Koculin, komisar Myslim Canin dhe zëvendës komisar Bejdo Isufin.

Në mbledhjen e parë operative të Guri i Vijës, Shimçan, u vendos:

- Në shtëpinë e Muli Bashës të vendosej infermiera dhe baza partizane, si dhe një dhomë për mësimin e gjuhës shqipe kundër analfabetizmit.

- Në shtëpinë e Shaban Torbës, mbledhjet e shtabit të batalionit.

- Në shtëpinë e Fasli Torbës, depoja e armatimit.

- Në shtëpinë e Selman Torbës, depoja e ushqimeve.

- Në shtëpinë e Beqir Torbës, dhoma e fjetjes së anëtarëve të shtabit.

Në kullën tonë, e gjithë familja u vu në shërbim të luftës.

Babai Muli shërbente si roje dhe korrier partizan. Në vitin 1994, për kontributin e tij, mori titullin “Veteran i LANÇL”.

Nënë Tushja, vajzat Meletja dhe Rexhia, partizanë të tjerë dhe infermiera Liri përkujdeseshin për plagët dhe ushqimin e luftëtarëve.

Kjo dëshmohej më së miri jo vetëm nga pllaka përkujtimore, që gjendet në atë kullë, por përveç dëshmive të banorëve të zonës kjo ngjarrje e arkivuar në Muzeun e Rrethit Dibër ku sipas vërtetimit të lëshuar nga Drejtori i Muzeut Dibër Gafur Zoto thuhet: “Shtëpia e z.Muli Basha nga fshati Shimçan Dibër, ka qenë bazë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në të janë mbajtur e trajtuar partizanët të plagosur. Të dhëna për të ka në dosjen VIII/1 që ruhet në fondet e muzeut”. Një gjë të tillë e dëshmojnë edhe Rexhep Stojku, i cili deklaroi se: “Nga shtëpia jonë që ishte bazë luftime, partizanët e Baralionit IV-tër të Brigadës V-të Sulmuese dërgoheshin për kurim të shtëpia e Muli Bashës, që ishte kthyer në spital për partizanët e plagosur”.

Një gjë të tillë dëshmon edhe Shaban Torba, Veteran i Luftës dhe Kryetar i Këshillit të LANÇL:

“Shtëpia e Muli Bashës ka qenë bazë e LANÇL dhe spital për partizanët e plagosur. Familja Basha vuri kokën në rrezik për shërbimin ndaj Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Ndaj edhe mban sot atë pllakë kujtimi.”

AMANETIN, SE TRET DHEU...

Tek hedh këto radhë m'u kujtuan fjalët e gjyshe Tushes, e cila më thoshte:

“Unë një ditë do iki nga kjo botë, por një gjë s'më len të qetë. Kemi vënë kokën në rrezik për luftën, ndaj mos harroni...”

Nëse lexon mesazhin e saj, kupton se kjo shtëpi që mbart një pllakë përkujtimore meriton më shumë.

Meriton të përjetësohet në muze për të lënë gjurmë mbi vitet e luftës 1944 kundër pushtuesit nazifashist, për çlir-

imin e vendit dhe për të evidentuar kontributin e familjes Basha, e cila ktheu shtëpinë e saj në spital për partizanët e plagosur të Batalionit IV të Brigadës V Sulmuese, duke vënë jetën në rrezik në shërbim të Atdheut dhe duke e bërë fshatin Shimçan një destinacion për t'u vizituar.

FAMILJA BASHA: -- TRE BREZA MISIONARËSH TË PAQES

Në jetën e çdo ushtaraku ka disa çaste që nuk i shlyen as koha, as largësia. Për ne, motoja “Kombi, Nderi, Atdheu!” nuk ishte thjesht një fjalë e bukur e shkruar në flamurë dhe dokumente zyrtare, por një besë që e mbanim në zemër, siç mbahet amaneti i të parëve. Ndihejshja i bekuar që më ishte besuar misioni i paqes, një detyrë që kërkon më shumë se armë dhe disiplinë — kërkon shpirt, guxim dhe dashuri për jetën e tjetrit.

Që nga viti 1996, qindra e mijëra ushtarë shqiptarë kanë përfaqësuar vendin tonë në misione ndërkombëtare paqeruajtëse, në krah të aleatëve të NATO-s, Bashkimit Evropian dhe Kombeve të Bashkuara. Të veshur me uniformën tonë, kemi shkelur në toka të huaja për të mbrojtur jetë, për të vendosur paqen atje ku kishte vetëm heshtje armësh e tym luftime.

Për ne si familje, kjo rrugë nuk ishte e rastësishme. Në trungun tonë janë rritur tre breza misionarësh të paqes. Nipi im, Nënkolonel Bekim Fisniku, ka kryer misione në Bosnje, Irak, Afganistan dhe Çad: këtu si komandant kontigjenti duke e ngritur flamurin ku kishte nevojë për paqe. Djali im, rreshter Besmir Basha, shërbeu në Afganistan e Kosovë, duke çuar në emër të Shqipërisë besimin dhe shpresën.

Edhe djali i vëllajt Bledar Basha, u bashkua në këtë mision në Afganistan, ku na nderoi në përmbushjen me sukses të misionit në mbështetje të paqes. E mes tyre, edhe unë, Major Nexhbedin Basha, pata nderin të jem pjesë e kontingjentit shqiptar në Herat, Afganistan, si shef personeli dhe psikolog i kontingjentit, si dhe kronikan e poet.


Një foto e përbashkët me të tre, para nisjes së njërit prej këtyre misionëve, është ndër kujtimet më të shtrenjta që ruan familja jonë. Nuk është thjesht një fotografi — është një amanet, një dëshmi se sakrificat, dashuria për atdheun dhe besimi në paqen janë vlera që trashëgohen dhe nuk zbehen kurrë.

E mbaj mend si sot udhëtimin drejt Afganistanit: një avion special na çoi deri në Dubai, e më pas me helikopter mbi shkretëtirën e pafund. Nga ajri, gjithçka dukej tokë e djegur, pluhur dhe gurë. Por mes asaj pamjeje të zymtë, në zemrat tona rrihte e njëjta ndjenjë: ne ishim aty për të shpëtuar jetë, për të ruajtur paqen dhe për të nderuar Shqipërinë tonë.

Ky ishte misioni ynë. Dhe këtë rrugë do ta vazhdojnë edhe brezat që vijnë pas nesh.

EPILOG POETIK

Kulla që rri zgjuar...
Kulla e fildishtë rri zgjuar,
Gjumi i është trazuar, trazuar,
Përplasje shikimesh si në ëndërr,



Kuturu enigmash pruar.
Unë dola prej bahçes sime,
Si të isha një shegë e egër,
Jeta në kullë, një film me metrazh,
Si zog shtegtar më mungojnë këngët.
Në udhën e dijes eca menduar,
Në autostradë, dy drejtëza paralele,

Te kryqëzimi, në semafor ngeca...
Nën lëkurë shfaqen sinjale të befta.
Sakaq përumbem në ëndrra menduar,
Shikimi yt mbeti një imazh,
Se sytë e tu rrinë zgjuar, zgjuar,
Sytë e tu, një maraz.

HISTORI

HITO KONGOCI-FUSHËBARDHA TOPÇIU I PARË SHQIPTARLUFTËTAR I SHEKUJVE

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Hito Kongoci ishte lindur në një truall luftarak dhe patriotik në pranverën e vitit 1810 në Fushëbardhë, por që tokat e fisit të tij të Kongoce ishin përtej qafës së Skërficës në Vërrin. Në Fushëvërrin kanë pasur tokat e tyre edhe shumë fise të tjera të njohura të Fushëbardhës si, Baho, Kazo, Kuci, Tefa, Shalari, Shkurti, Lagji, Këndezi, Deçka, Bello, Zervoi, Isaraj, Alidhima, Proda, Veliu, Kongoci, Golemi, Memushi, Cama, Rofi, Mullai, Resuli, Muho, etj. Jeta e Hito Muhamet Kongocit ishte një jetë e gdhendur në historinë e luftave të trevës labe. Familja e oxhakut të Kongoce kishte haurët sikurse gjithë fiset e tjera në Vërrin, edhe pse është vështirë ti përcaktosh identitetin fshaçë. Hito Kongoci del përtej rajonizimit fshatçë është më shumë se krahinor, i përket Labërisë, Shqipërisë. Në dekadat që pasuan pas rënies heroike të Hitos, Kongocajt i gjejmë në Fushëbardhë, në Fushëvërrin dhe në Kalasë por edhe në vende të tjera. Ishte koha kur pushtuesit osmanë kishin shtrirë sundimin në rajonet fushore e kodrinore dhe që egërsia e tyre në mbledhjen e taksave shkonte deri në rrëmbimin e kafshatës së fundit të bukës nga goja e fshatarëve, për të mbajtur gjallë dhe gjatë sundimin, për mbajtjen e një makinerie shumë të madhe njerëzish në ordunë/ushtrinë osmane. Nga ana tjetër djemuria shqiptare sapo mbushte moshën për rekrutim në askerllik/nizamllëk rrëmbehej “me hir e pahir” për të mbushur radhët ushtarake në tre kontinente në rreth 8 milionë km², ku shtriheshin Sulltanati dhe pushtimet osmane. Hito Kongoci u rrit sikurse gjithë moshatarët dhe mes vuarjtjeve por dhe taksave të rënda. Babai e gjyshi i tij në linjë stërgjyshërore kishin qenë kundërshtarë të pushtuesve, dhe nuk e njihnin “urtësinë”, kur ja kërkonte puna, edhe pse nga brenda nga zemërimi ishin zjarr përvëlues. Të mocmit thoshin se “rrebelimin e kishin në gjak”. Edhe pse e dinin fatin e të qenit “asker”, Hitua nuk ju shmang shërbimit të gjatë të detyrueshëm ushtarak shtatë vjeçar. Bashkë me shokë të fshatit, Labërisë, Delvinës etj, hipi vaporrit “Daut”, që kishte marrë djemuri shqiptare edhe në skelat e Ulqinit, Shkodrës, Shëngjinit, Durrësit e Vlorës. Ishte koha kur nizamllëku i kushtonte shqiptarëve më shumë se 14 mijë djem në vit që bë kryenin shërbimin në të gjithë anët e Sulltanatit Osman. Kështu vepronin dhe djemtë e Fushëbardhës që i merrnin “nizamë”, (rregull, rend, ligj), i çonin në Delvinë, dhe nga garnizoni i Delvinës grumbulloheshin djemtë që do bëheshin “askerllikun” i çonin në skelën e Sarandës. E kishte edhe kjo “të mirën” e vet dhe kjo e mirë ishte arti më i vështirë në botë që ishte lufta si art shkatërrimi.

Nizamllëku i kishte mësuar e burrëruar, në kufijtë ekstremë të jetës, u kishte mësuar artin luftarak osman, përdorimin e armëve, kamës, thikës, pushkës e deri edhe topat, që e kishin profesion të trashëguar në breza nga

• *“Kush e njëh Hito Fushëbardhë,/Jelexhveshur, pallëlarë,/Ngrehu topat e kalanë,/Në kuti ia hodhi zjarrë,/E dogji su dha i gjallë,/Në kala, në Koqinovë,/Hito Kongoci me kordhë,/Bën dyfek ruan sinorë,/Me venedikt e arhonë,../Me junanë e me osmanë./..*

tradita luftarake lridashëse. Askush nga djalëria e këtij vendi nuk e haronte anijen që i çonte në “anën tjetër të dynjasë, ku piqet buka në diell”, që i dërgonte në kazemat ushtarake/askeri këshllasënda, të Portës së Lartë “ajkën e djalërisë” shqiptare, në zbatim të fermanëve famëkeqë, që Sulltanati mbushte radhët ushtarake për të mbajtur pushtetin e pushtimit me zjarr e hekur, por më shumë me gjak. Njerëzit në brigjet shqiptare e quanin pampori i dhimbjes, mallëngjimit e shpresës.

Hito Kongocit dhe disa shokëve të tij i priu “fati”, që pas karantinës të caktuar në “Topçu Denizli” në mbrojtje të kështjellave detare osmane. Këtu mësoi principin e funksionimit të topave dhe mendjen e kishte në vatanin e tij. Vitet kaluan dhe qitapët e njësisë bregdetare i ofruan të qëndronte rrogetar, por nuk pranoi dhe u kthye i gjallë pas shtatë viteve në vendlindje. Hito Kongoci 25 vjeçar kishte ardhur në kohën kur ziente vendi nga rrebelimi dhe kryengritjet shqiptare. Shqiptarët i pritën me përbuzje traktatin e “Gylhanesë” (reformat e Tanzimatit të 1839-ës), që synonte konsolidimin e perandorisë osmane. Askush nuk ishte dakord me reformat e sulltan Abdyl Mexhitit, në fushën administrative, financiare, ushtarake e arsimore. Kështu reformat në vend që të qetësonin shqiptarët i hodhën “benzinë zjarrit” dhe kryengritjet u finalizuan më 1847, ndërkohë që Osmanët ishin shtrirë në gjashtë vilajete në Ballkan (në 165 mijë km², ku popullsia e Ballkanit nën pushtim ishte 5.5 milionë banorë).

Hito Kongoci ishte pjesë e të dënuarve për rrebelim, por është falur pasi mbashkë me kapedanë të tjerë të Labërisë u bë pjesë e detashmenteve labe që shkuan vullnetarisht si “redif”/rezervistë për të mbrojtur tokat shqiptare në vilajetin e Shkodrës (sot hapësira administrative e Malit të Zi). Hito Kongoci ju përgjigj thirrjes si redif/rezervist në mbrojtje të truallit arbëror të vilajetit të Shkodrës nën thirrjen: “Vilayet tehlikede”/vilajeti në rrezik!, dhe shkoi bashkë me Zenel Gjolekën, Hodo Ali Nivicën, Gjike Thanasin, Halim Toto Progonati, etj. Trimat e Labërisë filluan luftimet në zonën e Kërnicsës e pastaj u zgjerua dhe nga krahu i Taraboshit. Luftimet e detashmentit lab në veri kanë ngelur në kujtesën mbarëkombëtare edhe pse aty mbetën përjetësisht në altarin e lirisë si martirë të pavdekshëm të Atdheut. Hito Kongoci edhe pse u plagos dy herë munda të mbijetonte plagëve dhe nuk e dha veten. Ai u bë përsëri i aftë për luftë, por këtë herë për luftë kundër çdo pushtuesi si osmanë edhe andartë që vinin nga deti për zaptimin e trojeve shqiptare në jug. Në kohën që luftohej në veri për tokat



shqiptare lindi edhe kënga lapidar e Labërisë: “Përse lufton a derëzi?/ As për mua, as për ti,/Po për gjithë Shqipëri!”. Lufta për mëmëdheun përjetësohej në vargje: “Mëmëdheun nëpër shekuj,/vrrarë e prerë po kurrë vdekur,/ lumenj gjaku për flamur,/ Si nuk humbi pyet bota?/ Prerë me shtatë djegur me topa?/ Jo, nuk humbet shqiptari,/ e provon çelikin zjarri”.

Pas këtyre betejave nga veriu, greku kërcënonte nga Jugu dhe më 1854 përsëri një përballje e përgjakshme, por këtë herë armatosja e taborëve të redifëve shqiptarë bëhej në Delvinë dhe në Janinë dhe luftime të përgjakshme për mbrojtjen e tokës shqiptare në Petë, Mecovë, Artë dhe në të gjithë Çamërinë. Trimfuan mbi grekun e parë, por me osmanët nuk u bënë kurrë miq sepse mbeteshin në armiçësi të përjetshme. Por në këto vite në Labëri kishte një famë të madhe çeta e shquar e Bilbilinjve, që ishte me 13 vetë, por bilbilinj kishte në çdo fshat të Labërisë në të pesëqind fshatrat e saj. Kështu nga Fushëbardha kishte me dhjetra bilbilinj, pasi për nder të Bilbil Shakos komandantit të bilbilinjve, këtë emër merrte kushdo rrëmbente pushkën kundër pushtuesve. Kështu nga Fushëbardha bilbilinj të njohur sipas dokumenteve muzeale kanë qenë: Sadik Hazbi Memushi, Myrteza Sulli, Skëndo Habil Xhuvani, Musa Mustafa Rofi, Hito Kongoci, Gafur Kondi etj. Çdo fshat kundërshtonte taksat e rënda në mënyrën e vet, edhe pse mënyra më e ashpër dhe e drejtpërdrejtë ishte e bilbilinjve, që e përfunduan misionin e tyre duke u vetdorëzuar dhe “shkuan në litarë vetë,/bilbilinj të trembëdhjetë” më shkurt 1858. Bilbilinjët u varën në Janinë tek rrapi i falë, por ideali i tyre nuk u shua, vijoi të mbetej i ndezuar

prushi i atdhetarisë dhe i këndërshtimit të çdo lloj pushtuesi. Kështu ngeli i paepur Hito Kongoci, sikurse dhe prijësa, kapedanë e luftëtarë të tjerë të trevës labe. Luftëtarët shqiptarë në veri dhe në jug të vendit kanë qenë inovatorë në fushën e betejës. Të dhënat flasin se Hito Kongoci ose Hito Topçiu, ishte ndërtues i katër topave të gorricës në trevën labe në krahinën e Rrëzomës në nahijen e Delvinës. Topat e artilerisë së Hito Kongocit ishin një lloj artilerie artizanale, por funksionale, që futi panikun brenda formacioneve ushtarake të rregullta armike. Kjo metodë u përdor me efektivitet nga kryengritësit që e ndërtuan artilerinë jo me shkrirje topash por me artilerinë e vendit, me topa që ishin ndërtuar me palcën e drurit të gorricës, por edhe të lisit, të karfosura me unaza hekuri.

Këto topa prej druri u përdorën me efektivitet në luftën e Palavisë në Rrëzomë të Delvinës, ku përmendet në vargje kënge mjeshtri Hito Kongoci. Taborët e pushtuesve i zuri paniku kur “artileria shkëmbore nuk ishte vetëm në grykat e maleve që ishin të prishme për pushtuesin, por edhe në fushë të hapur, kur gjylet binin breshër dhe prishnin formacionin luftarak të armikut duke futur tmerr dhe frikë në radhët e tyre. Koqinova në krahinën e Rrëzomës në Delvinë u shndrua në një realitet të ri luftarak të panjohur më parë. Taborët armike njëhën një armë të re në duart e kryengritësve, topat që qëllonin nga se prisnin. Vendi do mbushej me gjyle dhe kështjella në Koqinovë do të shndrohej në një fortesë shumëdimensionale. Artileritë e Labërisë ngritën kështjellë dhe e fortifikuan në të gjithë drejtimet.

Kështjella natyrore solli një dimension të ri luftime. Prijësi dhe drejtuesi, topçiu i vjetër që i kishte kaluar të gjashtëdhjetat kishte përgatitur edhe topçinjtë e rinj, ata që kishin djersitur ditë e natë për ta bërë majën e Koqinovës me një emërtim të ri “Maja e Hito Kongocit”, për ta përjetësuar luftën në fushë e në kodër, në kështjellën e Koqinovës. Luftëtarët e çetës, zhvilluan një luftim mbrojtës mjeshhtëror, edhe nuk e prisnin që misioni i tyre të ishte kaq rezultativ si një “traktat luftime”. Ata nuk e dinin se edhe traktatin e luftës së artilerisë e shkruante një shqiptar në austri Gjergj Basta, por në fakt çeta labe po e zbatonte këtë traktat nga eksperiencia luftarake e shqiptarëve në shekuj, por dhe nga mjeshhtëria e drejtimit të Hito Kongocit. Hito Kongoci e gjeti lëndën e parë tek gorricat e vjetra të zonës, që kishte me shumicë, duke prerë disa nga trungjet më të fortë e që ja vlenin për misionin që i priste. Kjo u bë edhe

Vijon në faqen 13

OPINION

BAZAT E LANÇ-FORTESA QËNDRESE DHE FRYMËZIM PËR BREZAT

MEVLUD BUCI

Historia me gjurmët e saj të qëndresës përbën një frymëzim për brezat-aty ku zë fill krenaria kombëtare.

Në çdo fshat e zonë ka baza të luftës çlirimtare, por shumica prej tyre janë rrënuar. Ka pasur dikur muze të zonave me fotografi e relikte të dëshmorëve dhe të luftëtarëve, që sot nuk janë. Por edhe të popullsisë, burrave, grave që u bënë mikpritësa të luftëtarëve të lirisë dhe i ndihmuan ata me sa mundën për të luftuar armikun.

Shumë gjëra kanë ndodhur në këtë tranzicion të stërzgatur, mjaft koncepte janë përmbysur e të reja janë sendërtuar, por gjithmonë nderimi për luftëtarët e lirisë (me ndonjë luhatje) ka qenë i palëkundur.

Katër Grykët e Dibrës dikur kishte 6500 banorë, ndërsa sot në këtë zonë kanë mbetur më pak se 1000.

Rrjedhimisht, edhe shumë kulla janë braktisur. Edhe me to, duket se u braktis edhe ndonjë pllakë që ishte vënë në to si "Shtëpi e bazës së Luftës Nacionalçlirimtare".

E vërteta është se në këtë zonë, sipas kujtesës popullore, kishte mbi 20 shtëpi si baza të luftës, ndërsa pllaka u vendosën vetëm në dhjetë prej tyre.

Mungesa e pllakave në një kohë të caktuar të sundimit totalitar komunist nuk i tronditi këto kulla, të cilat vazhduan ta ruanin traditën mikpritëse po njësoj dhe as nuk i shtiu në zili për kullat e tjera që këto pllaka i kishin mbi qemerin e dyerve

Kjo se vepronte kriteri i luftës së klasave për shkakun se ndonjë shtëpi bazë e luftës i "tradhtoi" idealet komuniste ose nuk e përkrahu mënyrën sesi regjimi komunist i devijoi idealet e lirisë. Megjithatë, kujtesa popullore nuk gabon.

Në disa kulla dhe shtëpi me emër, si: Bardhi, Kazihani, Kalia, Buci, Sherhu, Ndrejoni, Bruçi, megjithëse kishin qenë shtëpi me emër, mikpritëse dhe patriotike, dhe kishin vënë gjithçka në dispozicion të luftës, këto pllaka nuk u vunë për arsye se ata kishin strehuar edhe nacionalistë dhe sipas



kodit malësor "dera për mikun është e hapur", ata kishin strehuar luftëtarë të lirisë, pavarësisht ngjyrave politike apo anësive të ndryshme të grupimeve komuniste që u evidentuan më vonë.

Mungesa e pllakave në një kohë të caktuar të sundimit totalitar komunist nuk i tronditi këto kulla, të cilat vazhduan ta ruanin traditën mikpritëse po njësoj dhe as nuk i shtiu në zili për kullat e tjera që këto pllaka i kishin mbi qemerin e dyerve.

Edhe ata kulla që kishin pllaka në atë kohë, si shtëpia e Cokës në Qafë Murrë, e Dervishëve në Lukan, e Ramës në Kacni etj(c)gjithej 10 të tilla nuk u mburrën për këtë, por shfaqnin nderimin për shtëpitë e tjera me emër që dhanë kontribut në luftë, megjithëse padrejtësia e kohës vazhdonte të heshtte "duke fshirë këtë kontribut" me një lojë djallëzore.

Kjo i përket një kohe të shkuar dhe sot jemi përpara një realiteti të ri. Re-

aliteti i mosvëmendjes sa duhet nga instancat përkatëse ndaj një periudhe të caktuar historike siç ishte Lufta Nacionalçlirimtare, realiteti i braktisjes për shkak të migrimit dhe emigrimit, që sjell nevojën sot, pas pothuajse tre dekadash për një rikthim të vëmendshëm në histori jo thjesht përmes kujtesës, por edhe dokumentacionit për të ndrequr gabimet e së shkuarës dhe për t'i dhënë vlerën çdo kulle.

Kulla të tilla baza të luftës, si ajo e Metës, Muçës, Canit, Laskut në Selishtë, Nelhanit e Ramës në Kacni, Cokës e Manrekës në Qafë Murrë etj etj, qëndrojnë së bashku në histori si vlera të simbolit të kujtesës atdhetare e çlirimtare. Këtë gjë e dëshmon edhe epika popullore me vargjet:

Kjo Selishta gur -kala,
Luftë po bakan burra e gra,
Qaj Manuka me openga
Kalasë së kuqe i hini mrena...

Realiteti i sotëm që po duket e me shenjat që ka dhe po kuptohet si rikthim i vëmendjes drejt malësisë-krahas investimeve të tjera si, rrugë, ujësjellës dhe bujtina, kërkon edhe zgjerimin e kësaj vëmendje dhe fokusimin në evidentimin e vlerave historike jo vetëm si vlerë e trashëgimisë fisnore luftarake-liridashëse, por edhe si atraksion turistik.

HITO KONGOCI-FUSHËBARDHA TOPÇIU I PARË SHQIPTARLUFTËTAR I SHEKUJVE



Vijon nga faqja 12

për faktin se faqja e malit të Lucës, por dhe mali i Lavanit kishte lisa që mund të shërbenin për këtë punë, por puna nuk priste, ndërkohë që për gjyle shërbenin gjithëfarë gurësh të rrumbullakosur por dhe copa metalesh e gjyle të vjetra të luftarave të mëparshme të zhvilluar në këtë zonë. Fillimisht bashkëluftëtarët e tij nuk e besonin nismën e Hito Kongocit, kur ai e vetë i pari. Gdhendja e drurit ishte një mjeshtëri e njohur e gjithë trevës labe. Por jo për të krijuar topa luftime. Kështu trunget ndaheshin më dysh dhe gdhendeshin me dalta, sopata e hanxharë. Hitua gjithë merak kishte siguruar edhe rrathë hekuri nga të bucelave dhe vedrave të staneve. Pasi përgatiti "bombardën e gorricë", që krahasur me drurët e tjerë, druri i gorricës është shumë i fortë dhe mund të realizojë tre deri në katër maksimumi pesë shtimje, forca e barutit e djeg dhe e çan, për këtë arsye u për-

gatitën edhe bombardat rezervë. Hitua ju tregoi se kur të çahet e para, bëjmë gati tjetrin. Kjo ishte një taktikë dhe strategji e panohur për pushtuesin dhe as që e prisnin që inkursioni i taboreve të pritej nga gjylat që kërcisnin mbi formacionet armike. Hito Kongoci kishte menduar edhe për barutin, për folenë e barutit, për shtupën e fortë dhe të padepërtueshme të gazrave si dhe gjylet (lënda vrasëse me gurë lumi të stërralltë, copëra hekurishtesh në formë saçme. Eshka e thatë mirë shërbente në vend të fitilit.

Edhe pse ka të dhëna të ndryshme rreth kohëpërdorimit të topit të gorricë, armiku gjithësesi braktisi fushën e luftës dhe u tërhoq në panik.


Armiku provoi ta shuante rezistencën dhe artilerinë e tyre të ngritur në kështjellën natyrore, por që edhe pas përdorimit të lëndëve djegëse nga pushtuesit, luftimi vijoi me të gjithë armët e deri në përleshje trup me trup, ku humbën jetën mjaft luftëtarë dhe një ndër më të njohurit është edhe shpikësi i artilerisë artilieri popullor, Hito Kongoci. Në Rrëzomë ende është Koqinova me histori ku shihen mbeturinat e kështjellës ngjajnë me një vend-guide muzeale që na kujtojnë brezit tonë dhe brezave që do të vijnë luftime për mbrojtje të truallit arbëror, por dhe topat e gorricë të prijësit komandantit, topçiu sypatrembur Hito Kongocit, si një trashëgimi historike e zonës, si një visar i çmuar të trimërisë labe sa të moçme aq edhe me

vlerë. Ndërkohë që kënga nuk rreshti për më shumë se dy shekuj dhe nuk do të rreshtë kurrë: "Kush e njeh Hito Fushëbardhë./Jelekzhveshur, pallëlarë./Ngrëhu topat e kalanë./Në kuti ia hodhi zjarrë./E dogji su dha i gjallë./Në kala, në Koqinovë./Hito Kongoci me kordhë./Bën dyfek ruan sinorë./Me venedikt e arhonë.../Me junanë e me osmanë./Për Vatanin e dha xhanë...". Disa organe të shtypit ushtarak shqiptar, si Gazeta "Ushtria", Revista "Mbrojtja", portali Alb-Spirit, gazetata "Labëria", "Rrënjët", "Veterani", "Kushtrim Brezash", revista "Pavdekësia", i kanë kushtuar vëmendje kësaj figure të madhe luftëtare, kanë kushtuar shkrime të posaçme për prijësin e luftëtarin e Fushëbardhës dhe të Labërisë Hito Kongoci, i cili ishte lindur në Fushëbardhë të Gjirokastrës dhe që ra në luftën e përgjakshme në rajonin e Koqinovës në Rrëzomë, Delvinë më 1878, duke ngelur përjetësisht emër i gdhendur në përjetësi në kujtesën e Labërisë dhe mbarë kombit shqiptar, i përjetësuar në këngë: "Kush u hodh proto i pari,/Hito Kongoci kordhëtar,/topçitë me top ia dhanë,/flaka i mori fustanë,/... si dhe nga ana tjetër kënga e përjetësoi këtë figurë madhështore të fushëbetjës: Kush e njeh Hito Fushëbardhë./Jelekzhveshur, pallëlarë./Ngrëhu topat e kalanë./Në kuti ia hodhi zjarrë...".Në pikëpamje dokumentare Organizata Kombëtare e Dëshmorëve të LANÇ-it dhe dëshmorëve të tjerë të Atdheut, Dega e Gjirokastrës, e ka vërtetuar

në mënyrë dokumentare, që specifikon se: "Hito Kongoci nga Fushëbardha është vrarë më 1878 në betejë kundër pushtuesve në luftën e Koqinovës në Rrëzomë të Delvinës". Në aspektin juridik legjislacioni shqiptar e lejon plotësisht që Hito Kongoci-Fushëbardha të shpallet me titullin "Dëshmor", sepse bazuar në aktin legjislativ të nenit 5, "Kriteret për shpalljen ose njohjen e statusit "Dëshmor i atdheut", pika "a" të ligjit nr. 109/2018, "Për statusin e Dëshmorit të Atdheut". Pika "a" thuhet: shpallen Dëshmorë të Atdheut "personat, të cilët kanë humbur jetën për lirinë, pavarësinë kombëtare dhe mbrojtjen e territoreve shqiptare apo në përpjekje për mësimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe para datës 28 nëntor 1912".

Meqënëse kësaj periudhe luftarake nuk ju është kushtuar vëmendje në periudhën që shkoi një maksimumi proverbiale, thotë se, "e drejta zhytet por nuk mbytet". Gjaku i ish-prijësit e luftëtarit Hito Kongoci nuk u harrua dhe nuk do të harrohet, por meriton pedestalin e mirënjohjes dhe të lavdisë, nderimin e të gjithë shqiptarëve. Emrin e Hito Kongoci nuk e harrojnë bashkëfshatarët, bashkëkrahinarët, Labëria e më gjerë, prandaj dhe përkujtohet, si luftëtar lirie. Hito Kongoci është një emër i paharrueshëm që ngeli i nderuar dhe respektuar në breza, ngeli në këngët e popullit që janë një arkiv më vete dhe një burim i pashtershëm i të dhënave historike labe dhe më gjerë.

SUPLEMENTI LETRAT



Dhjetëra personalitete akademike dhe të letrave në promovimin e librit tim të 29-të:

Mehdi Luca, embleme e qytetarisë dibrane

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

Para tre muajsh në promovimin e vëllimit të parë të librit tim “Dibra dhe dibranët në pamentonin e vlerave”, premtova se menjëherë do të nisja punën me vëllimin e dytë...

Sepse ishin vërtetë pak, 70 personalitet dibrane të portretizuara në vëllimin e parë, ndonëse të të gjitha trevave e fushave, si atdhetari i flaktë HARUN DOMI që solli abetarën e parë nga Bukureshti dhe u bë mësuesi i parë i shkronjave shqipe në Kalis e Kala të Dodës; Edip Daci që refuzoi të bënte betimin fashist në Romë, por që u arrestua pas ngjarjes absurde të ambasadës ruse në Tiranë; Nderi i kombit Hazis Ndreu- ezopi i Dibrës; Prof. Dr. Petrit Bara, personalitet i shquar i mjeksisë shqiptare me integritet të lartë; Nderi i kombit BUJR KAPEXHIU, që me veprën e tij krijuese si aktor, regjisor e shkrimtar ndër më të mirët renditet me eliten krijuese të kombit;

LIRI RASHA, pasaporta artistike e Dibrës; BAFTJAR RUSI, një emër i madh i drejtësisë shqiptare; Zeri i lavdisë shekullore Qerim Sula; MJESHTRI I MADH MUHARREM GJOKA, promovuesi i vlerave etnokulturore; HAMDË DODA, gjenerali nga Muhurri që ka përfaqësuar Shqipërinë në NATO, e dhjetra e dhjetra të tjerë..., shkrimtarët e mirënjohur dibranë: Ahmet Prençi, Prof. dr. fatmir Terziu, Fatos Daci, Sakip e Shpëtim Cami, Naim Berisha, Saimir Shatku, Barie Cupi, Avni Ndreu, Demir Rusi, Moza Shehi, Hysen Drvishi etj, por që kurresesi nuk përfaqësonin gjithë elitën dibrane.

Ndaj dhe në nisje të punës për vëllimin e dytë, ndalesa e parë që MEHDI ISLAM LUCA, monografi kjo që u promovua të pasditen e të premtës së 17 korrikun, së bashku me dokumentatn televiziv “Mehdi Luca, embleme e qytetarisë dibrane” (sipas skenarit tim) në Akademinë e Shkencave me praninë e dhjetra personaliteteve akademike dhe të letrave si dhe qindra përfaqësuesve të komunitetit dibranë në Tiranë, dhe jo vetëm,

Sepse një vit më parë, (2024) me interesimin dhe insistimin e nipit të tij, Dr.Zyber Gjoni unë hulumtova brenda një harku kohor të shkurtër dhe mundësova shkrimin dhe botimin e një portreti (In Memoriam) të tij në gazetën “VETERANI” dhe në prestigjiozën GAZETA DESTINACIONI... Dhe nuk isha gabuar. Menjëherë pas botimit, erdhën vlersësime nga personalitete të njohura dibrane për Mehdi



Lucën.

VLERËSIMET...

Prof. dr. Hajri Shehu vlerëson se: “Respekti nuk kërkohet. Respekti fitohet. Mehdi Luca e pati fituar respektin. Me punë e me sjellje. Në punë e kudo. Mehdi Luca është i gjallë për të gjithë ne. Me të gjitha të mirat që pati. Dhe s’ka më mirë, kur njeriu që ikën, është përsëri i gjallë”.

Ish – Ministrija e Arsimit dhe Kulturës, Tefta Cami, e vlerëson Mehdi Lucën si ish nxënësin shembullor të Internatit të famshëm të Kastriotit, si luftëtarin antifashist dhe drejtuesin e rinisë antifashiste gjatë LANÇ për krahinën Reç e Dardhës, si intelektualin e drejtuesin e shquar, si mikun e komshiun fisnik e të kulturuar që shquhej për thjeshtësi dhe mençuri... që me punën me pasion e profesionalizëm, mbolli pemën e pavdekësisë, sepse la një emër të mirë, që do të kujtohet e nderohet për shumë dekada nga pasardhësit e tij e të punonjësvë, si dhe nga qytetarët dibranë.

Prof. Dr. Petrit Bara – zv/rektor i Universitetit “LUARASI”, ndër të tjera tha se “Halil Rama, me librin e tij të 29-të, ka meritën e përjetësisë të Mehdi Lucës, një personalitet i Dardhës dhe i gjithë Dibrës që me veprimtarinë e tij jetësore mbi të gjitha fitoi titullin NJERI. Duket fare qartë kjo që në titullin sinjifikativ të kësaj monografie “MEHDI LUCA - Embleme e qytetarisë dibrane”.

Vetë forma kompozicionale e librit me pesë kapituj: “ZALL DARDHA NË RRJEDHËN E HISTORISË”, “TARTAJ, NJË EMËR I ASHPËR”; “KARRIERA E SUKSESSHME E MEHDI LUCËS NGA DREJTUES I LANÇ NË INSTITUCIONET DHE NDËRMARRJET E DIBRËS”; “KRIJIMTARIA LETRARE E MEHDI LUCËS” dhe “BASHKËKOHËSIT PËR

MEHDI LUCËN”, është një qasje e veçantë e autorit H.Rama për ta bërë atë sa më tërheqës për lexuesin. Është një libër objektiv, racional që përcjell vlera tek bashkëkohësit, qoftë me përshkrimin e ngjarjeve e fakteve të reja nga qëndresa e burrave të Dardhës kundër pushtuesve të huaj, ashtu dhe me portretizimet e babës Islam e të nënë Hanishes, miqtë e familjes së tij, si dhe solidaritetin vëllazëror e miqësor. Ndërsa përsa i përket personazhit kryesor të librit, Mehdi Luca, përveçse nga autori i mirënjohur Halil Rama, karakteri i tij burror, mençuria, mirësia njerëzore, thjeshtësia dhe vizioni i tij bashkëkohor, përcillen mjaftë qartë e bukur edhe nga opinionet e bashkëkohësve të tij.

“Libri monografik, “MEHDI LUCA – Embleme e qytetarisë dibrane”, i shkruar me një përkushtim dhe dashuri prej hulumtuesi, dokumentuesi, analisti nga pena e mirënjohur dhe kreative e Halil Ramës, është një vepër e një rëndësie, gjithësi të veçantë, së pari për komunitetin që i përket personazhi i saj, së dyti për brezat e ardhshëm, së treti për historinë dhe krijimin e një tradite të shkrimit të dokumentuar, traditë kjo, e cila i ka munguar dhe vazhdon t’i mungojë kulturës shqiptare”, -tha prof. Bara.

Në të njëjtën linjë edhe Prof.Bujar Kapexhiu – Nderi i Kombit, ndër të tjera në fjalën e tij përshëndetëse në promovimin e këtij libri tha se “Halil Rama ka marrë përsipër të vlerësojë personalitetet e Dibrës... Në 29 librat që ka botuar e promovuar në dy dekadat e fundit, Halili prezantohet si mjeshtër i profilit, duke krijuar personazhe që të mbeten në kujtesë. Autori përveçon protagonistë që vetëm syri i tij i mprehtë dhe mendja e tij pjellore i shpërfaq aq mjeshtërisht,

siç bërë edhe me Mehdi islam Lucën që e ka personifikuar si embleme të qytetarisë dibrane”.

Prefekti i Qarkut Dibër Nexhbedin Shehu – ish ushtarak & kuader i lartë në Ministrinë e Mbrojtjes me karrierë të shkëlqyer ushtarake, njerëzore dhe profesionale, ndërsa vlerësoi kontributin tim në fushën e letrave e veçanërisht monografinë kushtuar Mehdi Lucës, tha se personalitete të tilla duhen përjetësuar në veprat letrare.

Akademik Fatos Daci – Mjeshtër i Madh, pasi më uroi dhe përgëzoi për këtë botim të ri, tha ndër të tjera se: “Shërbimi që Halili I bën, ashti si të tjerë kolegë e kolegekunitetit dibranë në përgjithësi është i çmuar dhe me vlera të mëdha... Unë nuk jam brezi i Mehdi Lucës, por unë e ruaj në memorien time vizuale si një burrë të pashëm, të gjatë, të veshur mirë, të qetë, të heshtur që përcillte vetëm kirsit dhe fjalë miradije”.

Sakip Cami, studiues dhe poet i mirënjohur, duke folur në këtë promovim, ndër të tjerat vlerësoi se “Përvoja e Halil Ramës në fushën e monografive letrare, ku numëron dhjetë të tilla, (pesë për Dardhën dhe personalitetet e saj), ka bërë që edhe kjo monografi për Mehdi Lucën të rrjedhë lirshëm sikurse monografitë e mëparshme, ajo për Muharrem Xhedikun, Skënder Calën, Bajram Ndreun, Isuf Rashën etj., por pa përsëritur njëra tjetrën. Krahinat me histori dhe heronjtë e tyre meritojnë të shkruhet sa më shumë dhe vazhdimisht...”

Dr. ZYBER GJONI, tha ndër të tjera se: “Mehdi Luca nuk kishte grada shkencor por kishte diçka shumë më të çmuara “grada njerëzore”, që i kishte fituar duke u shërbyer njerëzve në nevojë me ndershmëri dhe përkushtim”.

Ndërsa Elmaz Lala – ish Shef i Seksionit të Arsimit e Kulturës në KE të KP të rrethit Dibër e kujton Mehdi Lucën si: “një burrë i urtë, i kulturuar, model i sjelljes shoqërore, fisnik edhe në paraqitje e komunikim, me pasion për librin, njeri që bënte vetëm miq e të “prisheshe” me të fajn kërkoje te vetja, një qytetar shumë i përgjegjshëm e që respektonte miqtë e derës së tij si pakkush”.

Qoftë edhe nga këto pak radhë kupton se Mehdiu ishte njeri i thjeshtë, njeri i mirë, i kudogjendur, që nga koha kur u mobilizua në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare e pas çlirimit si drejtues i Komitetit të Fiskulturës në Komitetin Ekzekutiv të KP të rrethit

Vijon në faqen 15

SUPLEMENTI LETRAT

TË VËRTETAT E HIDHURA NË TREGIMIN E KADRI TARELLIT

SHPENDI TOPOLLAJ

Për veprën disaplanëshe të Kadri Tarellit, nënkryetar i OBVL Durrës, kam folur gjatë. Edhe libri i autores të shquar Vilhelme Vranari kushtuar atij, thua- jse i ka thënë të gjitha. Ndaj për sot e gjeta të arsyeshme të përqendrohem vetëm te njëri nga tregimet e përfshira te libri i tij "Filxhani me buzë të kafshuar" me titullin "Kapelja i solli drutë". Ngjarja në dukje është e thjeshtë. Autori na përshkruan një nga kokëçarjet e panumërta të kohës që lamë pas. Por atë thjeshtësi, ai ka ditur ta veshë me shumë art, çka jo vetëm tregon se Kadriu tani ka arritur një shkallë mjaft të lartë të të shkruarit të tregimit, por edhe se fare mirë ky krijim mund të renditet me dinjitet në antologjinë e prozës tonë të shkurtër. Anëtar i Akademisë Franceze Alain Robbe Grillet ka thënë se "Shkrimtari i vërtetë nuk ka asgjë për të thënë. Gjëja që ka rëndësi është mënyra në të cilën e thotë". Pikërisht mënyra sesi Kadriu ka ditur të na e thotë atë që do, e bën këtë tregim mjaft tërheqës dhe interesant. Kini parasysh tregimet e Anton Pavloviç Çehovit. Ato rrokin tema shpesh edhe të rëndomta, marrë nga jeta e përditëshme, por të gjithë e dine se ato nuk të shqiten kollaj nga mendja për gjithë jetën. Personazhi kryesor është Samiu, një mësues fshati që atë ditë, para se të shkojë në shkollë të japë mësim, i futi krahët asaj parde- sysë që vishte rrallë, por që tani i rrinte disi ngushtë dhe pasi vuri në kokë një kapelë me strehë dhe mori në dorë një dosje të zezë, u nis të shkojë vetë andej nga Fusha e druve, se po bënte shumë ftohtë dhe nuk kishin me se të ngrohen. Ca më shumë që i ka ardhur edhe e ëma dhe gruaja dy herë që ka shkuar, nuk ka mundur të bindë dikë



që t'i sillnin triskën e druve të muajit. Kadriu flet për mësuesin Sami, por lexuesi nuk e ka të vështirë ta kuptojë, se mësuesi është vetë autori i tregimit. Madje, lexuesi duke nënqeshur disi hidhur, kupton se ai personazhi është edhe ai vetë. Se kujt nuk i ka ndodhur të shkojë e të baltoset dimrave me një kartmonedhë në dorë, duke iu lutur karrocierëve që ngisnin ca kuaj gërdallë, që u numëroheshin brinjët dhe u dilte shkumë nga goja, nga vrapit që detyroheshin të bënin, pas goditjeve të një kamzhiku të pamëshirë. Marrja e druve, si shumë të tjera, ishte një torturë e vërtetë. Bëri si bëri dhe e takoi përgjegjës, por pa sukses. Kishte lënë pa shkuar në mësim ato dy orët e para, ndaj nuk e la me kaq, por ashtu si me drojë shkon në zyrën e drejtorit. Ky sapo e pa, urdhëroi atë përgjegjës që rastësisht u gjend aty, që me një herë t'ia çonin drutë në shtëpi



qytetarit. Ai bëri ca naze, por kur mësuesi u kthye në darkë, u gëzua kur pa se dhoma ishte ngrohur. Po puna nuk mbeti këtu, pasi tani nisi komedia; u mor vesh se Drejtori e kishte marrë për oficer nga ata të Degës së Brendshme që zakonisht rrinin civilë. Pas pyetjes së nënës se mos i kishte gënjer, ja sesi e përshkruan situatën autori: "Samiu filloi të qeshë me zë të lartë.

Qeshte dhe shikonte, herë nënën e herë gruan, që s'po kuptonin asgjë, se nga i vinte gjithë ky gaz, kaq pa prituri e pa kujtuar. U ngrit në këmbë dhe qetë - qetë përqafoi nënën e pastaj gruan. U bë serioz në fytyrë: Drutë nuk i solla unë! - foli dhe u kthye nga dera, ku kish varur kapelen. E mori në dorë, i fërkoj strehën dhe e puthi, si gjë të çmuar e delikate. U zgjat, mori dhe dosjen, e fërkoj dhe atë butë - butë dhe duke qeshur tha: - Drutë i solli kapelja dhe kjo dosje". Në gjithë këtë his-

tori, ku mesa duket ai ka pasur parasysh atë sentencën që të ndahemi me të shkuarën duke qeshur, Kadriu ka operuar mjeshtërisht me planet psikologjike.

Personazhet janë portretizuar bindshëm dhe e kalojnë veten, duke u bërë përfaqësues të një realiteti të trishtuar, ku i dituri e dinjitozi, detyrohet të luajë të urtin, naivin e të nënshtruarin para injorantit, për të zgjidhur hallin që ka, dhe ky i fundit, qoftë nëpunës shteti apo edhe një copë karrocier, i jep vetes rëndësi e krekoset sikur i ka atij shpirtin në dorë. Për përgjegjësia drejtorin, nderi u bëhet vetëm miqve dhe shokëve me poste të larta drejtuese. Dhe e gjithë kjo, pra ky mentalitet, na jepet nëpërmjet një ironie e sarkazme me humor sa të hollë, aq edhe therës.

Dhe nuk ke sesi të shkruash tjetërsoj, kur telashe ke jo vetëm se mungojnë drutë, por edhe se nuk ka qumësh, vezë, mish, vajguri e sa e sa të tjera. Ja, ai shkon te "Katër Rrugët", tek ai oborri ku ka lënë biçikletën, por gomat kanë rënë dhe ai në gjithë atë rrugë për të mbërritur me vonesë në shkollë, e merr atë përdore. Gjithçka ndofta do të kalonte pa u vënë re, sikur shofer Zenuni, teksa punëtorët po shkarkonin drutë, të mos e kishte pyetur nënën e Samiut që u kishte nxjerrë nga një gotë raki: - Nëne! Çfarë pune bën djali yt...? Dhe ajo nuk ka arsye pse të mos i thotë të vërtetën: - Mësues, në një fshat andej nga Shijaku. Por ai, sikur ta kishte pickuar miza e kalit, shpërtheu i habitur dhe i zemëruar: - Si the, si the... mësues? Nuk është oficer? Unë e theksova qysh në krye, se Kadri Tarelli ka shkruar një tregim sa të thjeshtë, aq dhe të arrirë, si estetikisht, ashtu edhe për freskimin e kujtesës tonë me ato që kanë ngjarë. Por nuk duhet harruar se Marsel Prusti që një javë më parë kishte 154 vjetorin e lindjes, vërente se "Në gjërat e thjeshta mund të ketë po aq bukuri sa në gjërat më të çmuara".

Mehdi Luca, emblemë e qytetarisë dibrane

Vijon nga faqja 14

Dibër, si nëpunës finance në kooperativë e në disa ndërmarrje të Dibrës dhe mbi të gjitha babai i dy djemve, (sot burra e kryefamiljarë të shkëlqyer), dhe i vajzës, Kujtimes një zonjë fisnike e me inteligjencë të rrallë, etj.

Mehdi Islam Luca ishte ndër burrat e urtë e të mençur të odave e mexheliseve, të cilat përbënin shkallën më të lartë intelektuale të popullit të krahinës së Dibrës, për të zgjidhur probleme, që edhe drejtësia moderne do t'i kishte lakmi për mençurinë e përdorur nga "pleqet", që ndanin kuvendet, bashkonin njerëzit, pajtonin gjaqet, zgjidhnin problemet e pronës, u jepnin të drejtë njëerës palë, pa marrë parasysh rrangun a ofiqin që kishte pala tjetër...

BASHKËKOHËSIT.....

Shkrimin e kësaj monografie ma

bënë më të lehtë bashkohësit e Mehdi Lucës, si prof. Dr. Hajri Shehu; mishëruesi e përcuesi i mencurise dibrane Shuaip Methasani, 94 vjeçari Hysen LAÇI; artisti Skënder Cala, mjeshtër i madh; Kolonel Femi LUCA ish - oficer i Ushtrisë Shqiptare; Avni Ndreu- koreograf, Mjeshtër i Madh, nipi i prsonazhit dr. Zyber Gjoni, e bija e tij Kujtime Luca Ushtelenca, Bashkim Gjilaga, Dogjan Dervishi, Muharrem Gjoka, Idriz Kukeli e të tjerë, që e kujtojnë Mehdi Lucën si: MISHËRUES DHE PËRÇUES TE VLERAVE MË TË MIRA TË FISIT E FAMILJES; KUADËR KORREKT, I NDERSHËM DHE I DASHUR ME TË GJITHË; KOMUNIKUES BRILANT ME NJERËZIT DHE ORGANIZATOR I AFTË; si qytetarin e kuadrin e devotëshëm që DINTE TË FALTE VEÇ MIRËSI E DASHURI.

Besoj se për të gjitha këto virtyte Mehdi islam Luca ishte dhe mbetet

emblemë e qytetarisë dibrane.

Le ta kujtojmë e nderojmë si të tillë edhe në këtë 100 vjetor të ditëlindjes

së tij.

Tiranë, më 17.07.2025



SPECIALE

OBVLP U KRIJUA NGA 64 PERSONALITETE, ISH-DREJTUES TË LANÇ, TË USHTRISË SHQIPTARE E STRUKTURAVE TJERA QEVERTARE

31 VJET OBVLP, MBROJTËSE E VLERAVE TË LIRISË



Vijon nga faqja 3

morëve.

Në veprimtarinë e saj OBVLP nderoi kontributin e të përndjekurve politikë, sidomos të atyre të LANÇ e të ushtarakëve të spikatur që udhëhoqën luftën, por që padrejtësisht u pushkatuan, u burgosën, u dëbuan e internuan.

Gazeta "Veterani", organ i OBVLP

pasqyroi dhe pasqyron vazhdimisht veprimtarinë e kësaj organizate dhe ka ndihmuar në realizimin e objektivave dhe detyrave të saj.

Përveç 434 numrave të gazetës "Veterani" në këto 31 vjet, të shumta kanë qenë botimet e librave të veteranëve, të cilat jemi përpjekur ti promovojmë si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë.

OBVLP, në bashkëpunim me Organizatën e Veteranëve të LANÇ të

Kosovës, ka përgatitur dhe promovuar bujshëm edhe dy dokumentarët: "Rrahman Parllaku – Një legjendë në kufirin e tri kohëve" dhe "Fadil Hoxha - Arkitekti i Kosovës së lirë", dokumentarë këto që janë shfaqur si për publikun në sallën e Akademisë së Shkencave Tiranë dhe nga Radio Televizioni Publik Shqiptar (RTSH).

Në këtë 31-vjetor OBVLP vjen e konsoliduar, e bashkuar dhe me en-

ergji e vendosmëri për të lëvruar më tej, pasuruar më shumë historinë reale të LANÇ dhe për të dhënë kontributin e saj real për konsolidimin e demokracisë e të shtetit ligjor, për një Shqipëri anëtare e denjë e NATO-s që ecën vendosmërisht drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian.

Halil RAMA

***Sekretar i Përgjithshëm i OBVLP**